



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**V E N D I M**  
**K.P.P.300/2020**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 05.08.2020 shqyrtoi ankesën me:

- Objekt:** Shfuqizimin e vendimit të KVO-së mbi kualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Aurora Konstruksion” shpk në procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur*”, me nr. REF-51811-02-27-2020 me objekt Loti 1 “*Rikonstruksion i disa QSH- ve në qarqet Tiranë, Durrës, Dibër*” me fond limit 131,310,315 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 30.03.2020 nga autoriteti kontraktor, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.
- Ankimues:** BOE “Rafin Company” shpk& “Meteo” shpk  
Rruga “Gjik Kuqali”, Pallatet C&S, Kati 2, Zyra 1, Tiranë
- Autoriteti Kontraktor:** Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale  
Rruga e Kavajës, nr. 1001, Tiranë
- Baza Ligjore:** Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “*Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “*Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksonimin e Komisionit të Prokurimit Publik”*”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjeve, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

## V Ë R E N:

### I

#### *Vlerësimi paraprak*

1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar;

I.2. Bashkimi i operatorëve ekonomikë ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar.

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik;

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues.

### II

#### *Rrethanat e çështjes*

II.1 Në datën 27.02.2020 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, procedura e prokurimit “*Procedurë e Hapur*”, me nr. REF-51811-02-27-2020 me objekt Loti 1 “*Rikonstruksion i disa QSH- ve në qarqet Tiranë, Durrës, Dibër*” me fond limit 131,310,315 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 30.03.2020 nga autoriteti kontraktor, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

II.2. Në datën 30.03.2020 autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit, objekt ankimi.

II.3. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor rezultoi se në datën 05.05.2020 autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës, nëpërmjet sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, ku rezultoi si më poshtë vijon:

Kevin Konstruksion	88,877,686 (oferte e korigjuar 99,737,860)	I skualifikuar
Aurora Konstruksion	94,706,540(oferte e korigjuar 93,509,729.9)	I kualifikuar
Dajti Park 2007&Glavenica	96,972,915.14(oferte korigjuar 97,083,501.5)	I skualifikuar
Sireta 2F	99,999,999 (oferte e korigjuar 99,982,575.83)	I kualifikuar
Rafin Company&Meteo	100,963,923 (ofertë e korigjuar 99,102,591)	I kualifikuar
Almo Konstruksion&Ulza	101,558,282 (ofertë e korigjuar 101,572,856.96)	I skualifikuar
Company Riviera&Kacdedja	104,690,944 (ofertë e korigjuar 102,825,982.5)	I kualifikuar
BE-IS&Ergi	113,256,720 (ofertë e korigjuar 111,217,822.5)	I kualifikuar
Alko Impex& 2T	117,621,33.6 (ofertë e korigjuar 116,339,421.66)	I kualifikuar
Ante Group	123,722,537 (ofertë e korigjuar 123,722,538.25)	I kualifikuar

II.4. KPP vëren se renditja e operatorëve ekonomikë pjesmarrës referuar vlerave të korigjuara të ofertave për Lotin 1 rezulton si më poshtë:

Aurora Konstruksion	(oferte e korigjuar 93,509,729.9)	I kualifikuar
Dajti Park 2007&Glavenica	(oferte e korigjuar 97,083,501.5)	I skualifikuar
Rafin Company&Meteo	(ofertë e korigjuar 99,102,591)	I kualifikuar
Kevin Konstruksion	(oferte e korigjuar 99,737,860)	I skualifikuar
Sireta 2F	(oferte e korigjuar 99,982,575.83)	I kualifikuar
Almo Konstruksion&Ulza	(ofertë e korigjuar 101,572,856.96)	I skualifikuar
Company Riviera&Kacdedja	(ofertë e korigjuar 102,825,982.5)	I kualifikuar
BE-IS&Ergi	(ofertë e korigjuar 111,217,822.5)	I kualifikuar
Alko Impex& 2T	(ofertë e korigjuar 116,339,421.66)	I kualifikuar
Ante Group	(ofertë e korigjuar 123,722,538.25)	I kualifikuar

II.5. Në datën 08.05.2020 BOE “Rafin Company” shpk& “Meteo” shpk ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor në mënyrë të përmbledhur me argumentat si më poshtë:

- *Nuk jemi dakord me vlerësimin e bërë nga ana e KVO pasi shoqëria Aurora Konstruksion është kualifikuar në kundërshtim me ligjin dhe rregullat e prokurimit publik me pretendimin si më poshtë:*
- *Pretendimi i parë: Në gjykimin tonë pjesmarrja e operatorit ekonomik Aurora Konstruksion në të gjitha lotet objekt prokurimi është haptazi në shkelje ligjore. Operatori ekonomik Aurora Konstruksion shpk është kualifikuar në kundërshtim me ligjin dhe rregullat e prokurimit publik pasi nuk përmbush kapacitetet për të ekzekutuar kontratat.*
- *Sqarojmë se referuar nenit 9 të VKM nr.914 datë 29.12.2014 i ndryshuar pika 5: Kontrata ndahet në lote, kur përbëhet nga punë, mallra apo shërbime, homogjene ose të ngjashme, dhe kur vlera e kombinuar është e tillë që vetëm një numër i kufizuar operatorësh ekonomikë do të ishin në gjendje t'i siguronin ato. Kjo mënyrë mund të përdoret veçanërisht për të nxitur pjesëmarrjen e biznesit të vogël e të mesëm dhe për të ulur kostot administrative të autoritetit kontraktor.*
- *Neni 74 i VKM së sipërcituar parashikon: Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë*

*procedurës dhe në rast përzgjedhjeje edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi.*

- *2. Para dorëzimit të ofertës, bashkimi duhet të krijohet zyrtarisht, me një marrëveshje të noterizuar, ku të përcaktohen përfaqësuesi i grupit, përqindja e pjesëmarrjes së punës/shërbimit/furnizimit dhe elementet konkrete, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi. Pas krijimit të bashkimit të operatorëve ekonomikë, anëtarët e bashkimit caktojnë me procure përfaqësuesin e tyre për dorëzimin e ofertës. Kjo marrëveshje e shkruar dhe prokura duhet të dërgohen së bashku me kualifikimet dhe ofertën ekonomike, e cila duhet të nënshkruhet nga përfaqësuesi. Përfaqësuesi duhet të bëjë edhe sigurimin e ofertës, nëse kërkohet, duke specifikuar pjesëmarrjen në bashkimin e operatorëve ekonomikë. Në rast se bashkimi i operatorëve ekonomikë shpallet fitues, kontrata duhet të nënshkruhet nga secili prej anëtarëve të këtij bashkimi.*
- *3. Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat ligjore, të parashikuara në nenin 45 të LPP dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në akt marrëveshje.*
- *Sa më sipër për sa kohë që në mënyrë specifike lex specialis, LPP dhe aktet nënligjore në zbatim të tij kërkojnë në mënyrë të shprehur se: Kërkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në akt marrëveshje.*
- *Pra në kuptim të ligjit të posacëm jo vetëm kërkohet në mënyrë eksplicite që kërkesat duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi por edhe në përputhje me formën e parashikuar në ligj me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim të përcaktuara në akt marrëveshje.*
- *Lidhur me këtë pikë nga interpretimi literal i neneve sa më sipër kriteret në të gjitha lotet janë kumulative të vecanta dhe duhet të plotësohen në mënyrë të specifikuar sipas të gjitha kërkesave të përcaktuara në shtojcën 12 të DT kriteret të vecanta. Rrjedhimisht operatorët ekonomikë të interesuar dhe pjesëmarrës duhet të përmbushin e plotësojnë të gjithë kapacitetet teknike, ekonomike, financiare dhe kualifikimin profesional. Dyshojmë që operatori ekonomik Aurora Konstruksion shpk (pjesëmarrëse në të gjitha lotet) të plotësojë kërkesat e përcaktuara dhe kërkuar në mënyrë eksplicite në të gjithë procedurat në të cilat është anagazhuar JV me operatorë të tjerë. Pra rrjedhimisht jo vetëm që nuk janë përmbushur kërkesat dhe bashkimi në formën e kërkuar nga ligji por edhe nuk disponohen kapacitetet për të ekzekutuar procedurën.*
- *Në shtojcën 12 të DT është përcaktuar qartësisht: Pjesëmarrja në më shumë se një Lot*
- *Nëse një operator ekonomik konkuron në më shumë se 1 lot të kësaj procedure prokurimi atëherë ai duhet të zotërojë kapacitetet teknike, ekonomike financiare dhe kualifikimin profesional për të realizuar objektin e procedureve të prokurimit,*

pra te gjitha loteve se bashku. Ne kete kuptim edhe kriteret e vecanta per kualifikim (si psh kategorite e licensave, nr. i punonjesve dhe mjeteve , kontratat e ngjashme, xhiro., etj) duhet te plotesohen nga operatori ekonomik ne varesi te loteve qe ai konkuron.

- Referuar nenit 26 pika 7/d te RRPP vleresimi mbi kategorite e licences, do te behet me radhe per secilin lot, duke pasur parasysh qe vlera e punimeve qe ka ofertuesi ne proces (perfshire lotin/lotet per te cilet eshte mbyllur vleresimi dhe eshte shpallur fitues ne kete procedure) nuk tejkalon vleren e punimeve sipas kategorive te licences profesionale te ofertuesit.
- Persa i takon licensave, te kihet parasysh qe sipas loteve ku oferton te paraqese kategorite e licensave sipas tabelës së mëposhtme:

<b>kombinim lotesh</b>	<b>PUNIM E Germimi NP1</b>	<b>Rikonstruksi on dhe mirembajtje godinash civ&amp;industr , veshje godinash NP3</b>	<b>NS.2 - Impiante hidrosanitar e, etj</b>	<b>NS.12 - Impiante teknologjike , termike dhe te kondicionim it</b>	<b>NS.14 - Impiante te brendshme elektrike, telefonike, radiotelefoni, TV,</b>
<b>LOT 1+LOT 2</b>	A	E	B	A	B
<b>LOT 1+LOT 3</b>	A	D	B	A	B
<b>LOT 1+LOT 4</b>	A	D	B	A	B
<b>LOT 2+LOT 3</b>	A	E	B	A	B
<b>LOT 2+LOT 4</b>	A	E	B	A	B
<b>LOT 3+LOT 4</b>	A	D	B	A	B
<b>LOT 1+LOT 2+LOT 3</b>	A	E	B	A	B

<b>LOT 1+LOT 2+ LOT4</b>	A	E	B	A	B
<b>LOT 1+LOT 3+ LOT4</b>	A	E	B	A	B
<b>LOT 2+LOT 3+ LOT4</b>	A	E	B	A	B
<b>LOT 1+LOT 2+ LOT3 +LOT 4</b>	A	F	C	A	B

- Nëse një operator ekonomik konkuron në më shumë se 1 lot të kësaj procedure prokurimi atëherë ai duhet të zotërojë kapacitetet teknike, ekonomike financiare dhe kualifikimin profesional për të realizuar objektin e procedurës së prokurimit pra të gjitha loteve së bashku. Në këtë kuptim edhe kriteret e vecanta për kualifikim (si psh kategoritë e licencave, numri i punonjësve dhe mjeteve, kontratat e ngjashme, xhiro etj) duhet të plotësohen nga operatori ekonomik në varësi të loteve që ai konkuron.
- Në rastin konkret operatori ekonomik Aurora Konstruksion është pjesëmarrëse në të gjitha lotet. Pra sa i takon aftësive teknike, profesionale, mjete etj gjykojmë se ndarja e një procedure prokurimi në lote realizohet atherë kur vetë kontrata përbëhet nga punë, mallra apo shërbime, homogjene ose të ngjashme.
- Në gjykimin tonë në rast se operatorët ekonomikë janë pjesëmarrës në të gjitha lotet e procedurës së prokurimit atherë kjo do të jetë e njëvlefshme me marrjen pjesë në të gjithë procedurën e prokurimit dhe shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave në përputhje me kërkesën e autoritetit kontraktor në drejtim të plotësimit të kapacitetit të tij teknik duhet të jetë në përputhje me kërkesën e autoritetit kontraktor për të gjitha lotet së bashku për sa kohë që qëllimi final i operatorit ekonomik i shfaqur përmes angazhimit të tij të deklaruar për të qenë një fitues potencial i të gjithë procedurës së prokurimit (të gjithë loteve të vecanta) atherë ky i fundit duhet të dëshmojë se plotëson kapacitetin e tij ekonomik për të gjithë grup lotet ku ka marrë pjesë në përputhje me kërkesën e autoritetit kontraktor dhe në interpretim të zgjeruar të parashikimeve ligjore të LPP dhe akteve të tjera ligjore.
- Së dyti në shtojcën 12 pika 2.3.2 është vendosur kriteri kualifikues si më poshtë:

### **2.3.1 Përvojë e suksesshme në realizimin e të paktën:**

- a. Punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë prej 50% të fondit limit të këtij loti, të realizuar gjatë tri viteve të fundit. (3 vitet e fundit nga data e zhvillimit të procedurës së prokurimit të këtij loti ).
- b. Punë të ngjashme deri në një kufi ku vlera monetare totale e punëve të kryera e marrë së bashku gjatë tre viteve të fundit është sa dyfishi i fondit limit të këtij loti (realizuar gjatë 3 viteve të fundit nga data e zhvillimit të procedurës së prokurimit të këtij loti ).

**Plotesimi i njerit prej dy kushteve të sipërpermendura e bën oferten të kualifikueshme.**

\*Kur konkurohet për më shumë se një lot vlera e kërkuar do të jetë:

a. Në masën 50% të fondit limit të shumës së loteve për të cilat konkurron.

b. Sa dyfishi i fondit limit të shumës së loteve për të cilat konkurron.

Operatori ekonomik Aurora Konstruksion është kualifikuar në kundërshtim me ligjin dhe rregullat e prokurimit publik pasi nuk plotëson kriterin e sipërpërmendur për punë të ngjashme sepse kontratat e ngjashme të paraqitura prej tij nuk plotësojnë vlerën e kërkuar në kriterin e përcaktuar në pikën 2.3.2 dhe konkretisht pjesën e kriterit Kur konkurohet për më shumë se një lot vlera e kërkuar do të jetë:

a. Në masën 50% të fondit limit të shumës së loteve për të cilat konkurron.

b. Sa dyfishi i fondit limit të shumës së loteve për të cilat konkurron.

Nga informacioni që kemi ky operator ka qenë pjesëmarrës dhe është kualifikuar në të 4 lotet e publikuara nga autoriteti kontraktor , informacion të cilin e përforcon edhe Njoftimi i skualifikimit i publikuar nga autoriteti kontraktor më datë 05.05.2020 (ku për operatorin ekonomik Aurora Konstruksion është bërë shënimi: Operatori ekonomik kualifikohet por nuk mund të shpallet fitues në më shumë se një lot se kapacitetet e tij pasi sipas sqarimit të NjP ngarkuar në SPE).

- Lidhur me pikën 2.3.7.
- 2.3.7 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të deklarojë inxhinierin e ndërtimit, inxhinierin h/teknik ose mekanik dhe elektrik që do të jenë në kantier sipas grafikut të punimeve:
- Per qarkun Tirane: 2 inxh.ndërtimi; 1 inxh h/teknik ose mekanik dhe 1 inxh.elektrik.
- Per qarkun Durrës: 1 inxh.ndërtimi; 1 inxh h/teknik ose mekanik dhe 1 inxh.elektrik.
- Per qarkun Diber: 1 inxh ndërtimi, 1 inxh elektrik dhe 1 inxh.h/teknik/mekanik
- Per secilin prej këtyre inxhinierëve të kantierit sipas pikes 4.1 duhet të paraqiten kontratat e punës brenda afatit të vlefshmerise se këtij objekti, diplomat dhe cv.

- *Mbështetur në kriteret e përcaktuara në DT përvojën që kemi në fushën e prokurimeve publike kemi bindjen se ofertuesi Aurora Konstruksion nuk plotëson kërkesën e përcaktuar në pikën 2.3.7 të DT pasi kontratat e dorëzuara për inxhinierin e ndërtimit, inxh h/teknik ose mekanik dhe elektrik që do të jenë në kantier për qarqet Durrës, Tiranë dhe Dibër pasi dyshojmë që nuk janë të rregullt nga ana formale (ku përfshihet nënshkrimi nga palët) nuk janë brenda afatit të vlefshëmrisë së objektit të prokurimit si dhe nuk janë të siguruar në listpagesat e shoqërisë për periudhën shtator 2019-shkurt 2020.*
- *Pika 2.3.8. 2.3.8. Të ketë në stafin e punonjesve te pasqyruar ne list pagesa punonjës të pajisur me deshmi kualifikimi te sigurimit teknik nga IQT ose ekuivalente me te, të vlefshme: 5 (pese) punonjës elektrikist; 5 (pese) punonjës hidraulik/mekanik; 4(kater) punonjës murator; 3 (tre) punonjës pllakashtrues; 3 (tre) punonjes bojaxhi; 2 (dy) saldatore. Per punonjesit e siperpermendur te paraqiten deshmitë perkatese te kualifikimit te sigurimit teknik si dhe kontrata e punes (te vlefshme). Mbështetur në kriteret e përcaktuara në DT përvojën që kemi në fushën e prokurimeve publike kemi bindjen se ofertesit Aurora Konstruksion nuk plotëson kërkesën e përcaktuar në pikën 2.3.8 lidhur me disponimin nga ana e tij të 5 punonjësve hidraulik/mekanik dhe 5 punonjës elektrikist pasi punonjësit e sipërpërmendur nuk janë të siguruar me kodet përkatëse sipas VKM nr.514 datë 20.09.2017 Për listën kombëtare të profesioneve.*
- *Pika 2.3.6. Operatorët ekonomike pjesëmarrës duhet te kenë drejtues teknik të punësuar per periudhen e kerkuar **Shtator 2019- Shkurt 2020** të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, CV:*
  - *Inxhinier Ndërtimi*
  - *Inxhinier Mekanik ose H/teknik*
  - *Inxhinier Elektrik*

*Mbështetur në kriteret e përcaktuara në DT, përvojën që kemi në fushën e prokurimeve publike kemi bindjen se ofertuesi Aurora Konstruksion nuk plotëson kërkesën e përcaktuar në pikën 2.3.6 pasi drejtuesit teknik të kërkuar nuk janë të siguruar me kohë të plotë për periudhën shtator 2019-shkurt 2020 sikurse parashikon VKM nr.41 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimii ndryshuar.*

*Pra në mënyrë të përmbledhur nënvizojmë faktin se në vlerësimin e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit të ndarë në lote, në rast se operatori ekonomik Aurora Konstruksion referuar informacioneve tona shfaqet në cilësinë e subjektit pjesëmarrës në të gjitha lotet si edhe në kushtet e parashikimit në vetë dokumentat e procedurës së prokurimit, ku në rast se një operator ekonomik apo bashkim operatorësh që konkuron për dy ose më shumë lote tek kriteret e vecanta të kualifikimit përcaktohet ai duhet të ai duhet të*



zotërojë kapacitetet teknike, ekonomike financiare dhe kualifikimin profesional për të realizuar objektin e procedurës së prokurimit pra të gjitha loteve së bashku. Në këtë kuptim edhe kriteret e vecanta për kualifikim (si psh kategoritë e licencave, numri i punonjësve dhe mjeteve, kontratat e ngjashme, xhiro etj.

Pra duhet të plotësohen në përputhje me vlerën e përlllogaritur të kontratës/ si shumë aritmetike e kapaciteteve të kërkuara për cdo lot pra autoriteti kontraktor duhet ti referohet vlerësimit të kriterëve në përputhje me grupin e loteve të procedurës së prokurimit ku subjekti shfaqet në cilësinë e operatorit ekonomik pjesmarrës . Në rastin konkret operatori ekonomik Aurora Konstruksion nuk plotëson pikën 2.3.5 numri i punonjësve , 2.3.6 stafi inxhinjerik, 2.3.7 ndarjen e inxhinjerëve sipas qarqeve për të gjitha lotet , 2.3.8 punonjësit e specializuar, 2.3.10 mjetet. Për referencë citojmë përgjigjen e dhënë nga ana juaj në sistem kërkesave për sqarim e cila qartazi saktëson që kapacitetet duhet të jenë të vecanta dhe të ndara sipas qarqeve rrjedhimisht edhe sipas loteve.

- Pretendimi nr.2:
- Mbetjen të skualifikuar të ofertës së shoqërisë Dajti Park si ofertë ekonomike me gabime aritmetike mbi 2%.
- Në shtojcën 12 pika 2.3.8. Të ketë në stafin e punonjesve te pasqyruar ne list pagesa punonjës të pajisur me deshmi kualifikimi te sigurimit teknik nga IQT ose ekuivalente me te, të vlefshme: 5 (pese) punonjës elektrikist; 5 (pese) punonjës hidraulik/mekanik; 4(kater) punonjës murator; 3 (tre) punonjës pllakashtrues; 3 (tre) punonjes bojaxhi; 2 (dy) saldatore. Per punonjesit e siperpermendur te paraqiten deshmitë perkatëse te kualifikimit te sigurimit teknik si dhe kontrata e punes (te vlefshme). Mbështetur në kriteret e përcaktuara në DT përvojën që kemi në fushën e prokurimeve publike kërkojmë shtimin e arsyeve të skualifikimit për ofertuesin Dajti Park pasi nuk plotëson kërkesën e përcaktuar në pikën 2.3.8 lidhur me disponimin nga ana e tij të 5 punonjësve hidraulik/mekanik 3 punonjës bojaxhi dhe 5 punonjës elektrikist pasi punonjësit e sipërpërmendur nuk janë të siguruar me kodet përkatëse sipas VKM nr.514 datë 20.09.2017 Për listën kombëtare të profesioneve.
- Sa më sipër kërkojmë rivlerësimin e procedurës së prokurimit duke skualifikuar ofertën e shoqërisë Aurora Konstruksion si dhe mbetjen të skualifikuar Dajti Park pasi nuk ka plotësuar kërkesat për kualifikim të dhëna në DT.

II.6. Në datën 14.05.2020 BOE “Rafin Company” shpk& “Meteo” shpk ka marrë dijëni lidhur me mospranimin e ankesës nga autoriteti kontraktor.

II.7. Në datën 21.05.2020 pala ankimuese “Rafin Company” shpk & “Meteo” shpk, ka dorëzuar ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjtin objekt ankese drejtuar autoritetit kontraktor.

II.8. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor rezulton se në datën 05.05.2020 operatori ekonomik “Kevin Konstruksion” shpk është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi për arsyet si më poshtë vijon.

- *Nuk përmbush kushtin për punë të ngjashme sipas kërkesës në pikën 2.3.1 të KVK në DT sipas kontratave të realizuara gjatë tre viteve të fundit nga data e zhvillimit të procedurës së prokurimit sipas kërkesës në DT. Janë konsideruar punime të ngjashme kontratat me objekt të ngajshëm me objektin e prokurimit Ndërtim , rikonstruksion, dhe mirëmbajtje godina civile kulturale dhe industriale në pëprthje me licencën NP-3 Rikonstruksion dhe mirëmbajtje godinash civile e industriale veshje fasadash sipas kërkesës së DT.*
- *Nuk plotëson kërkesën për pasijet nivelues betoni sipas kërkesës në pikën 2.3.10 të KVK (Fatura Nr. 36 datë 04.08.2019 për helikopterët e betonit nuk është e rregullt).*
- *Operatori ekonomik nuk plotëson numrin mesatar për punonjësit e kërkuar sipas kërkesës në pikën 2.3.7 të KVK në DT. OE nuk ka në dispozicion me kohë të plotë fuqi punëtore të kërkuar sipas pikës 2.3.7 të KVK në DT. Shumë punonjës që ka paraqitur sipas profesioneve të kërkuara rezultojnë me nga një ditë punë për periudhën 6 mujore ndonëse për ta janë paraqitur kontrata pune me kohë të plotë.*

II.9. Në datën 11.05.2020 operatori ekonomik “Kevin Konstruksion shpk ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor në mënyrë të përmbledhur me argumentat si më poshtë:

- *Kundërshtojmë arsyen e skualifikimit që ka të bëjë me kontratat e ngjashme pasi është një arsye e pabazuar në prova dhe fakte.*
- *Në kriteret e vecanta të kualifikimit autoriteti kontraktor ka kërkuar:*
- *Punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë prej 50% të fondit limit të këtij loti, të realizuar gjatë tri viteve të fundit. (3 vitet e fundit nga data e zhvillimit të procedurës së prokurimit të këtij loti ).*
- *Punë të ngjashme deri në një kufi ku vlera monetare totale e punëve të kryera e marrë së bashku gjatë tre viteve të fundit është sa dyfishi i fondit limit të këtij loti (realizuar gjatë 3 viteve të fundit nga data e zhvillimit të procedurës së prokurimit të këtij loti ).*
- ***Plotesimi i njerit prej dy kushteve të siperpërmendura e ben oferten të kualifikueshme.***
- *\*Kur konkurohet për më shumë se një lot vlera e kërkuar do të jetë:*
- *a. Në masën 50% të fondit limit të shumës së loteve për të cilat konkurron.*
- *b.Sa dyfishi i fondit limit të shumës së loteve për të cilat konkurron.*
- ***2.3.2 Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit Ekonomik do të kryhet bazuar në deklaratat e dokumentat e mëposhtme:***

- a) Për kontrata të realizuara me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:
1. Deklaratën sipas shtojcës Nr. 9, shoqëruar me:
  2. Kontratë,
  3. Situacionin përfundimtar;
  4. Aktin e kolaudimit;
  5. Fatura tatimore per cdo situacion punimesh. (ku të shprehen qartë datat, vlera, koha dhe natyra e punës së bërë)
- b) Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:
1. Deklaratën sipas shtojcës Nr. 9, shoqëruar me:
  2. Kontrate;
  3. Situacionin përfundimtar;
  4. Akt kolaudimi objekti;
  5. Fatura tatimore per cdo situacion punimesh.

*Pika 2.3.2/a plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse pika 2.3.2/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.*

*Në përmbushje të kriterit sa më sipër shoqëria jonë ka paraqitur kontrata si në vijim:*

- Kontrata nr.910/6 Prot datë 24.01.2013 nënshkruar midis autoritetit kontraktor Universiteti Aleksandër Moisiu Durrës dhe operatorit ekonomik Kevon Konstruksion shpk me objekt: Vazhdimi i ndërtimit të Godinës së re të Kampusit Universitar , godina e dytë për Universitetin Aleksandër Moisiu Durës me vlerë 636,303,341 lekë me tvsh.
- Shtesë kontratën nr.58/1 prot datë 14.01.2016 nënshkruar midis autoritetit kontraktor Univeristetit Aleksandër Moisiu Durrës dhe operatorit ekonomik Kevin Konstruksion shpk me objekt Vazhdimi i ndërtimit të Godinës së re të Kampusit Universitar godina e dytë për Universitetin Aleksandër Moisiu Durrës me vlerë 113,000,638 lekë me tvsh.
- Shtesë kontratën nr.1292 prot datë 29.12.2016 nënshkruar midis autoritetit kontraktor Universitetit Aleksandër Moisiu Durrës dhe operatorit ekonomik Kevin Konstruksion shpk me objekt Vazhdimi i ndërtimit të Godinës së Re të Kampusit Universitar godina e dytë për Universittein Aleksandër Moisiu Durrës me vlerë 14,020,363 lekë me tvsh
- Situacionet përfundimtare të kontratës bazë dhe të shtesave
- Faturat Tatimore të prera për punën e kryer në një numër prej 38 copë nga viti 2013 deri në 003.10.2018 me një vlerë totale prej 753,624,346 lekë me tvsh prej të cilave fatura të prera brenda 3 veteve të fundit 2017-2018-2019 arrijnë vlerën e 223,056,216 lekë me tvsh.
- Akt Kolaudimi datë 24.09.2018
- Certifikatë marrje në dorëzim të puimeve datë 21.10.2019

- Formular vlerësimi lëshuar nga autoriteti kontraktor për realizimin me sukses të kontratës dhe shtesë kontratave në një vlerë totale 763,302,131 lekë me tvsh.
- Nga verifikimi i zërave të situacioneve për punimet për kontratën dhe shtesë kontratën të referuar më sipër dhe nga krahasimi i tyre me zërat e preventivit të publikuar nga autoriteti kontraktor në SPE rezulton se ato janë 100% të përputhshme madje janë identike dhe e tejkalojnë disa fish vlerën e kërkuar nga autoriteti për punë të ngjashme.
- Për sa më sipër pretendimi i autoritetit se nuk kemi paraqitur punë të ngjashme sipas kategorive objekt prokurimi nuk qëndrojnë.
  
- Gjithashtu shoqëria jonë ka ngarkuar në sistem edhe kontrata e mëposhtme:
- Kontrata nr.1269/3 prot datë 29.03.2017, nënshkruar midis autoritetit kontraktor Univeristetit Aleksandër Moisiu Durrës dhe operatorit ekonomik Kevin Konstruksion shpk me objekt Punimet për sistemimet e jashtme në godinën e dytë të Univeristetit Aleksandër Moisiu Durrës të ndërtuar në tuallin e Kampusit të ri Spitallë Durrës me vlerë 53,793,350 lekë me tvsh.
- Situacionet përfundimtare të kontratës
- Akt Kolaudimi datë 10.09.2018
- Faturat Tatimore të prera për punën e kryer në një numër prej 3 cop nga data 02.10.2017 deri në 07.08.2018 në një vlerë totale prej 53,793,287 lekë me tvsh prej të cilave fatura të prera brenda tre viteve të fundit 2017-2018 arrijnë vlerën e 53,793,287 lekë me tvsh.
- Certifikatat e përkohshme për marrje në dorëzim punimesh datë 20.09.2018
- Formular vlerësimi lëshuar nga autoriteti kontraktor për realizimin me sukses të kontratës në një vlerë totale 53,793,350 lekë me tvsh.
- Nga verifikimi i zërave të situacioneve për punimet për kontratën të referuar më sipër dhe nga krahasimi i tyre me zërat e preventivit të publikuar nga autoriteti kontraktor në SPE, rezulton se ato janë të ngjashme me ato të kërkuara nga autoriteti kontraktor për punë të ngjashme.
- Për sa më sipër pretendimi i autoritetit se nuk kemi paraqitur punë të ngjashme sipas kategorive objekt prokurimi nuk qëndron.
  
- Rezulton gjithashtu që shoqëria jonë ka ngarkuar në sistem edhe kontratat e mëposhtme:
- Kontrata Nr.5042 prot datë 11.08.2017 nënshkruar midis autoritetit kontraktor Bashkia Librazhd dhe operatorit ekonomik Kevin Konstruksion shpk me objekt Rikonstruksioni dhe rehabilitimi i Qendrës Kulturore të Fëmijëve me vlerë 43,320,772 lekë me tvsh
- Situacioni përfundimtar i kontratës
- Faturat Tatimore të prera për punën e kryer në një numër prej 5 cop nga data 25.08.2017 deri në 06.02.2018 në një vlerë totale prej 42,872,762 lekë me tvsh prej të cilave fatura të prera brenda tre viteve të fundit 2017-2018 arrijnë vlerën e 42,872,762 lekë me tvsh.
- Akt Kolaudimi datë 15.01.2018

- *Certifikatat e përkohshme për marrje në dorëzim punimesh datë 18.04.2018*
- *Formular Vlerësimi lëshuar nga autoriteti kontraktor për realizmin me sukses të kontratës në një vlerë totale 42,872,763 lekë me tvsh.*
- *Akoma më tej kemi ngarkuar edhe një kontratë si më poshtë: Kontratë Nr.P/Pune/2017/Goa/P71Prot datë 04.05.2017 nënshkruar midis autoritetit kontraktor FSHZH dhe operatorit ekonomik kevin Konstruksion shpk me objekt “Rruga Mborje në kufi me Kosovën” me vlerë 63,981,177 lekë me tvsh*
- *Situacioni përfundimtar i kontratës*
- *Faturat tatimore të prera për punën e kryer në një numër prej 6 copë nga data 07.08.2017 deri në 21.11.2018 në një vlerë totale prej 63,980,221 lekë me tvsh prej të cilave fatura të prera brenda 3 viteve të fundit 2017-2018 arrijnë vlerën e 63,980,221 lekë me tvsh.*
- *Akt Kolaudimi datë 25.10.2018*
- *Certifikatë e përkohshme e marrjes në dorëzim të punimeve datë 01.11.2018*
- *Formular Vlerësimi lëshuar nga autoriteti kontraktor për realizmin me sukses të kontratës në një vlerë totale 63,980,053 lekë me tvsh.*
- *Për sa referuam në këtë kontratë dhe nga krahasimi me kujdes i zërave të preventivit të prokuruar me zërat e situacionit përfundimtar të punimeve të realizuara del qartë se ka zëra të vecantë që janë të njëjtë midis tyre. Përfundimisht arsyeja e parë e skualifikimit jo vetëm që është e pabazuar por është tërësisht abuzive.*
- *Kundërshtojmë arsyen e dytë të skualifikimit që ka të bëjë me kërkesën për pasijet nivelues betoni (fatura numër.36 datë 04.08.2009 për helikopterët e betonit nuk është e rregullt) pasi është një arsye e pabazuar në prova e në ligj.*
- *Në kriteret e kualifikimit autoriteti ka kërkuar: Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që kanë dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës (shtojca10)*

<i>Mjetet</i>	<i>Sasia</i>	<i>Gjendja</i>
<i>Kamioncine deri 3 ton kapaciteti mbajtes per secilen</i>	<i>5cope</i>	<i>Pronesi ose qira</i>
<i>Kamion per furnizimin me materiale dhe largimin e mbeturinave nga objekti me goma dhe kapacitet mbajtes 5-10 ton dhe vetshkarkues</i>	<i>3 cope</i>	<i>Pronësi ose me qira</i>
<i>Elektrobetoniere/betoniere per pergatitje betoni dhe llaci ne objekt me kapacitet min 0.3m3</i>	<i>9 copë</i>	<i>Pronësi ose me qira</i>
<i>Motogjenerator me fuqi deri 5kva</i>	<i>10 copë</i>	<i>Pronësi ose me qira</i>
<i>Elektrovinc (i levizshem) me karel te levizshem horizontalisht me kapacitet ngrites</i>	<i>3 cope</i>	<i>Pronesi ose me qira</i>

0.3-0.5 ton		
Matrapik	5 cope	Pronesi ose qira
Nivelues betoni	5 cope	Pronesi ose qira
ekskavator goma ose zinxhir 0.25 m <sup>3</sup>	2 cope	Pronesi ose me qira
Depozita uji 1.000 lt	12 cope	Pronesi ose me qira
Pompe suvatimi	10 cope	Pronesi ose me qira

***Për të dëshmuar këtë, Formulari i shtojcës 10 të DSTduhet të shoqërohet me dokumentet e mëposhtme:***

- *Për mjetet, nëse janë në pronësi duhet të paraqiten faturat e blerjes ose të zhdoganimit të tyre.*
- *Për mjetet, nëse janë me qera, duhet të paraqiten kontratat e qerave ku afati i marrjes me qera të mbulojë afatin e përfundimit të punimeve të objektit dhe faturat e blerjes ose të zhdoganimit të tyre.*
- *Për mjetet që shënohen në regjistra publike, nëse janë në pronësi, duhet paraqitur dokumenti që vërteton **regjistrimin (leje qarkullimi), certifikatën e kontrollit teknik, policën e sigurimit vjetor.***
- *Për mjetet që shënohen në regjistra publikë, nëse janë me qera, duhet paraqitur dokumenti që vërteton **regjistrimin (leje qarkullimi), certifikatën e kontrollit teknik, policën e sigurimit vjetor, dhe kontrata e qerasë e cila duhet të mbulojë afatin e përfundimit të punimeve të objektit.***

*Në përmbushje të kriterit të vecantë të kualifikimit të nënvizuar më sipër shoqëria jonë ka paraqitur faturën nr.36 datë 04.08.2009, nënshkruar dhe vulosur nga pala shitëse dhe nënshkruar nga blerësi dhe transportuesi për Helikop Betoni 10 copë. Për sa më sipër rezulton se fatura përmbush tërësisht kriteret formale ligjore. Për sa më sipër arsyeja e skualifikimit nuk është aspak e bazuar në ligj.*

- *Kundërshtojmë arsyen e tretë të skualifikimit që ka të bëjë me .....*
- *Në kriteret e vecanta të kualifikimit autoriteti kontraktor ka kërkuar: Operatori Ekonomik duhet të ketë numrin e nevojshëm të punonjësve për zbatimin e kontratës. Numri i punonjësve për periudhën **Shtator 2019- Shkurt 2020** të jetë mesatarisht **95 punonjës në muaj** (përfshirë dhe stafin drejtues teknik dhe jo drejtues teknik-inxhinierë si dhe stafin me certifikate IQT ose e barazvlefshme ), të vërtetuar me;*
- *Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj për periudhën **Shtator 2019- Shkurt 2020.***
- *List- pagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohej nga legjislativi në fuqi për periudhën **Shtator 2019- Shkurt 2020.***

- Në përmbushje të kriterit të vecantë të kualifikimit shoqëria jonë ka paraqitur:
  - Listpagesat shkarkuar nga sistemi elektornik i tatimeve për periudhën Shtator 2019-Dhjetor 2019 dhe Janar -Shkurt 2020 për një numër mesatar punonjësish mbi 95 të kërkuar në kriterin e vecantë të kualifikimit.
  - Vërtetim Nr.T01957437 datë 28.03.2020 shkarkuar nga sistemi e-albania për periudhën Shtator 2019-Dhjetor 2019 dhe Janar Shkurt 2020 për një numër mesatar punonjësish mbi 95 të kërkuar në kriterin e vecantë të kualifikimit.
  - Kujtojmë këtu se përpara se shoqëria jonë të merrte vendim për të marrë pjesë në tender verifikoi kriterin për numër punonjësish dhe vetëm pasi u siguruam se në kriter nuk ishte kërkuar numër punonjësish me kohë të plotë vendosëm të marrim pjesë në konkurs. Për sa më sipër arsyeja e skualifikimit të shoqërisë sonë është e bazuar mbi një kriter të pakërkuar dhe si e tillë është tërësisht e paligjshme.
  
  - Kundërshtojmë ndërhyrjen në ofertën tonë ekonomike pasi është një veprim i paautorizuar nga shoqëria jonë dhe si i tillë konsiderohet ndërhyrje në ofertë duke e modifikuar atë. Rezulton se autoriteti kontraktor jo vetëm që nuk ka kërkuar sqarime për ofertën tonë por duke vijuar me shkeljet ligjore as që na ka njoftuar për këto korrigjime duke e bërë procedurën e pavlefshme. Për sa më sipër veprimet e autoritetit kontraktor janë në shkelje të hapur të LPP dhe për këtë do të kryhen kallzimet penale për anëtarët e KVO pasi kemi të bëjmë me shpërdorim detyre.
  
  - Kundërshtojmë kualifikimin e shoqërisë Rafin Company shpk për arsyet si në vijim:
  - Në kriteret kualifikuese autoriteti kontraktor ka kërkuar: 2.3.8. Të ketë në stafin e punonjësve të pasqyruar në list pagesa punonjës të pajisur me deshmi kualifikimi të sigurimit teknik nga IQT ose ekuivalente me të, të vlefshme: 5 (pese) punonjës elektrikist; 5 (pese) punonjës hidraulik/mekanik; 4(kater) punonjës murator; 3 (tre) punonjës pllakashtrues; 3 (tre) punonjës bojaxhi; 2 (dy) saldatore.
  - Per punonjës të siperpermendur të paraqiten deshmitë perkatëse të kualifikimit të sigurimit teknik si dhe kontrata e punës (të vlefshme).  
Në dijeni tonë operatori Rafin Company shpk nuk ka plotësuar kriterin e lartpërmendur për shkak se: Në bazë të VKM Nr.514 datë 20.09.2017 kodet e profesoioneve të personave të paraqitur si specialist të certifikuar në listpagesat e operatorëve duhet të figurojnë si më poshtë:
- |                         |            |
|-------------------------|------------|
| Elektricitist kodi 7411 | 5 punonjës |
| Hidraulik kodi 7126     | 5 punonjës |
| Mekanik kodi 3115       | 5 punonjës |
| Murator kodi 7112       | 4 punonjës |
| Pllakashtruesi 7122     | 3 punonjës |
| Bojaxhiu 7131           | 3 punonjës |
| Saldatori 7212          | 2 punonjës |

*Operatori ekonomik Rafin Company shpk referuar listpagesave të kësaj shoqërie nuk vërteton se ka të pasqyruar në to profesionet e mësipërme në numrin përkatës të kërkuar nga autoriteti kontraktor më sipër kjo në kundërshtim me kriterin kualifikues. Për këtë arsye oferta ekonomike e këtij operatori ekonomik nuk duhej kualifikuar dhe duhet anuluar vendimi për kualifikimin e tij.*

- *Në kriteret kualifikuese autoriteti kontraktor ka kërkuar:*
- *Shoqeria duhet të paraqesë Certifikatat e cilësisësi me poshtë:*
  - a. *Certifikatën e cilësisë së punimeve **ISO 9001-2015** (e vlefshme)/ose/ekuivalent. Certifikata të jetë leshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.*
  - b. *Certifikatën për Sistemin e menaxhimit të mjedisit **ISO 14001-2015** (e vlefshme). /ose/ ekuivalent. Certifikata të jetë leshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.*
  - c. *Certifikatën **OHSAS 18001-2015**, për Sistemin e menaxhimit të shëndetit dhe të sigurisë në punë (e vlefshme)/ ose/ **ISO 45001:2018**/ose ekuivalent. Certifikata të jetë leshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.*

*Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë certifikatat e kërkuara të cilësisë sipas zërave të që merr përsipër të realizojë në akt marrëveshje.*

*Nëpërmjet informacioneve tona rezulton se operatori ekonomik Rafin Company shpk nuk ka plotësuar kriterin e lartpërmendur për shkak se: Certifikimi ISO dhe OHSAS i operatorëve ekonomikë është kryer nga operatorë të paakredituar për të leshuar këtë certifikatë. Akreditimi i subjekteve që kryejnë certifikimin bëhet nga DPA. Verifikimi i listës së subjekteve të akredituara kryhet në adresën elektronike [info@dpa.gov.al](mailto:info@dpa.gov.al). DPA është autoritet publik që vepron si shërbimi kombëtar i akreditimit në RSH në varësi të MF.*

*Kualifikimi i operatorëve ekonomikë me certifikata të leshuara nga subjekte të paakredituara në RSH është një veprim shumë i rëndë i KVO dhe i autoritetit kontraktor që sjell si pasojë përgjegjësi administrative dhe në disa raste edhe penale. KVO në punën e vet analitike duhet të kushtonte vëmendje detajeve të lartpërmendura që përbëjnë diferencën në kualifikimin dhe renditjen e operatorëve. Në kundërshtim me kriterin kualifikues nuk ka paraqitur certifikata të ligjshme dhe në përputhje me praktinë e ndjekur prej KPP në raste analoge.*



*Për këtë arsye oferta e këtij operatori ekonomik duhet refuzuar*

- *Në kriteret kualifikuese është kërkuar: Kamioncine deri 3 ton kapaciteti mbajtes per secilen 5 copë ku Për mjetet që shënohen në regjistra publike, nëse janë në pronësi, duhet paraqitur dokumenti që vërteton regjistrimin (leje qarkullimi), certifikatën e kontrollit teknik, policën e sigurimit vjetor. Për mjetet që shënohen në regjistra publikë, nëse janë me qera, duhet paraqitur dokumenti që vërteton regjistrimin (leje qarkullimi), certifikatën e kontrollit teknik, policën e sigurimit vjetor, dhe kontrata e qerasë e cila duhet të mbulojë afatin e përfundimit të punimeve të objektit.*

*Nga informacione të sigurta rezulton se operatori ekonomik Rafin Company shpk nuk ka paraqitur dokumentacion të vlefshëm për 5 kamioncina me kapacitet deri në 3 ton sic është kërkuar në kriteret kualifikuese dhe pavarësisht kësaj KVO as që është impenjuar për këtë mangësi duke favorizuar këtë operator.*

- *Në kriteret kualifikuese është kërkuar: Punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë prej 50% të fondit limit të këtij loti, të realizuar gjatë tri viteve të fundit. (3 vitet e fundit nga data e zhvillimit te procedures se prokurimit te ketij loti ).*
- *Punë të ngjashme deri ne nje kufi ku vlera monetare totale e punëve të kryera e marrë së bashku gjatë tre viteve të fundit është sa dyfishi i fondit limit të këtij loti (realizuar gjatë 3 viteve të fundit nga data e zhvillimit te procedures se prokurimit te ketij loti ).*

***Plotesimi i njerit prej dy kushteve te siperpermendura e ben oferten te kualifikueshme.***

***\*Kur konkurohet për më shumë se një lot vlera e kërkuar do të jetë:***

***a. Në masën 50% të fondit limit të shumës së loteve për të cilat konkurron.***

***b.Sa dyfishi i fondit limit të shumës së loteve për të cilat konkurron.***

*Nëpërmjet informacionit të siguruar prej shoqërisë sonë nga buletinet e prokurimeve publike sigurojmë autoritetin kontraktor se shoqëria Rafin Company shpk nuk e plotëson këtë kriter kualifikues pasi vlerat e punëve të ngjashme të kryera prej kësaj shoqërie nuk plotësojnë shumën prej 50% për një kontratë të vetme apo 200% për më shumë se një kontratë krahasuar me fondin limit të prokuruar.*

*Pra shoqëria Rafin Company shpk nuk vërteton me dokumentacion ligjor se plotëson kriterin kualifikues punë të ngjashme të përfunduara në vlerat e kërkuara nga autoriteti kontraktor për këtë lot.*

*Shenim i ankimesit (operatori ekonomik Aurora Konstruksion edhe pse rezulton e kualifikuar në këtë lot nuk do të shpallet fitues ka theksuar AK pasi nuk përmbush kushtet kumulative pasi është shpallur fitues në një lot tjetër.*

*Për sa më sipër kërkojmë kualifikimin e shoqërisë sonë  
Skualifikimin e shoqërisë Radin Company shpk.*

II.10. Në datën 18.05.2020 me shkresën nr.1076/26 prot autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje operatorit ekonomik “Kevin Konstruksion” shpk ku ka vendosur mospranim e ankesës.

II.11. Në datën 26.05.2020 pala ankimese “Kevin Konstruksion” shpk, ka dorëzuar ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjtin objekt ankesë dorëzuar pranë autoritetit kontraktor.

II.12. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor rezulton se në datën 05.05.2020 operatori ekonomik BOE “Dajti Park 2007” shpk& “Glavenica” shpk është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi për arsyet si më poshtë vijon.

- *Operatori Glavenica nuk përmbush kushtin për punë të ngjashme sipas kërkesës në pikën 2.3.1. të KVK në DT të realizuara gjatë tre viteve të fundit në përputhje me pjesmarrjen në BOE. Janë konsideruar punime të ngjashme kontratat me objekt të ngjashëm me objektin e prokurimit Ndërtim , rikonstruksion, dhe mirëmbajtje godina civile kulture dhe industriale në përputhje me licencën NP-3 Rikonstruksion dhe mirëmbajtje godina civile e industriale veshje fasadash sipas kërkesës së DT. Nuk janë konsideruar si punë të ngjashme me objektin e prokurimit si rrugë, autostrada, mbikalime, ura, ujësjellës, kanalizime, ndërtime për nënstacione, kabina dhe linja të shpërndarjes TL dhe të mesëm etj (të cilat i përkasin licencave të zbatimit NP-4, NP-5, NP-74, NP-11 etj).*
- *BOE nuk ka paraqitur deklaratën me emrat e inxhinierëve në terren sipas kërkesës në pikën 2.3.7 të KVK në DT.*
- *BOE nuk plotëson kërkesën për mjetet sipas kërkesës në pikën 2.3.10 të KVK në DT 2 copë eksavator (goma ose zinxhir) 0.25 m3. Në kontratat e qerasë afati i marrjes me qera nuk mbulon afatin e përfundimit të punimeve në objekt sikurse është kërkuar në DT. Konsiderohet devijim i vogël pasi kontrata mund të përsëritet.*
- *Operatori Glavenica nuk përmbush kërkesat për disa pajisje në përputhje me pjesmarrjen në BOE. Nivelues betoni ka 1 copë nga dy që duhet të ketë. Pompë suvatimi ka dy copë nga 4 që duhet të ketë. Motogjeneratorë ka copë nga 4 që duhet të ketë.*

II.13. Në datën 11.05.2020 operatori ekonomik “Dajti Park 2007” shpk& “Glavenica “shpk ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor në mënyrë të përmbledhur me argumentat si më poshtë:

- *Për sa i përket arsyes së skualifikimit për mospërmbushje të kërkesës për punë të ngjashme ju informojmë se KVO ka qenë i padrejtë dhe i pasaktë. Arsyeja juaj për skualifikim duke moskonsideruar si punë të ngjashme kontratat me objekt punime kanalizimesh, ndërtime për nënstacione, kabina dhe linja të shpërndarjes së TL dhe të mesëm duke konsideruar se i përkasin vetëm pikave të licencave të zbatimit NP-4, NP-5, NP-7 etj nuk qëndron pasi nëse ju do ti referoheshit dhe do merrni në shqyrtim situacionet përfundimtare të paraqitura në SPE për këto kontrata, qartë do të vihej re që zërat e punimeve përkojnë me pikën e licencës së kërkuar NP-3. KVO i ka përjashtuar këto kontrata si punë e ngjashme pa shqyrtuar situacionet dhe zërat e punimeve që janë realizuar sipas pikës së licencës NP-3 dhe që përkojnë me natyrën e punimeve që janë objekt prokurimi.*
- *Operatori ekonomik Glavenica shpk në përmbushje të pikës 2.3.1. të kapacitetit teknik të kriterëve të vecanta të DT ka paraqitur si punë të ngjashme 7 kontrata të cilat plotësojnë vlerën e kërkuar në varësi të përqindjes së pjesmarrjes në bashkimin e operatorëve ekonomikë. Sa më sipër sqaruar kërkojmë që AK të rivlerësojë dokumentacionin e paraqitur në SPE duke gjykuar jo vetëm mbi objektin e secilës kontratë por të konsiderojë dhe vlerësojë në total të gjitha zërat e punimeve sipas situacioneve përkatëse. Vlerësimi i kryer nga KVO në këtë rast është i magët dhe i paplotë.*
- *Shoqëria Glavenica shpk si shoqëri me një eksperiencë të gjatë në treg posedon një sërë punësh të ngjashme dhe me paraqitjen e të njëjtave kontrata si punë e ngjashme në disa AK është kualifikuar dhe shpallur fitues dhe skualifikimin tuaj në këtë drejtim e konsiderojmë diskriminues. Në këtë kuadër kërkojmë rishikimin dhe rishqyrtimin nga ana juaj e të gjitha punëve të ngjashme të cilat do i gjeni bashkëlidhur edhe në versionin hard copy në mënyrë që të përlllogarisni më qartë vlerën monetare totale të tyre.*
- *Përsa i përket pretendimit tuaj për mosparaqitje të deklaratës për inxhinierët në terren ju sqarojmë se kjo është një arsye e padrejtë skualifikimi dhe lehtësisht e kundërshtueshme në SPE. Në përmbushje të kriterit 2.3.7 të kapacitetit teknik të DT bashkimi i operatorëve ekonomikë Dajti Park 2007 shpk& Glavenica shpk ka paraqitur shtojcat ku janë deklaruar inxhinierët të cilët janë të paangazhuar në kontrata të tjera dhe që do të jenë në kantier sipas grafikut të punimeve që do të realizohen, specifikisht në secilin qark. Këto shtojca janë dorëzuar së bashku me DT si pjesë totale e ofertës sonë. Në këtë kuadër duke e konsideruar të padrejtë dhe tendencioz vendimin e KVO kërkojmë rivlerësimin e këtij kriteri. Bashkëngjitur gjeni një kopje të shtojcave lidhur me inxhinierët të cilat janë paraqitur edhe në SPE.*

- *Përsa i përket arsyes së skualifikimit lidhur me eskavatorët me kapacitet 0.25 m<sup>3</sup> ju informojmë se kjo arsye skualifikimi jo vetëm që është e padrejtë pasi është dorëzuar dokumentacioni faktit që vërteton disponimin e këtyre eskavatorëve por vetë KVO është antagonist në formulimin e kësaj arsyeje skualifikimi. Në arsyen e skualifikimit është cituar se : KVO e konsideron devijim të vogël edhe e përdor si arsye skualifikimi. Jo vetëm që KVO është në kundërshtim të plotë me legjislacionin pasi devijimi i vogël nuk e bën një ofertë të pavlefshme por gjithashtu edhe nëse e konsiderojmë përmbajtjen e skualifikimit sërish nuk qëndron pasi në SPE në total janë paraqitur 7 eskavatorë ku ka eskavatorë në pronësi si dhe me qera disa vjecare që e mbulojnë afatin e përfundimit të punimeve. Kërkojmë që AK të rivlerësojë këtë kriter dhe të korigjojë antagonizmin dhe pasaktësinë e KVO.*
- *Arsyeja e fundit e skualifikimit jo vetëm që është e pasaktë, e padrejtë por tregon edhe një mungesë të theksuar të profesionalizmit të vlerësimit të ofertave. Duke pasur qëllim skualifikimin në tërësi të ofertës së paraqitur nga bashkimi jonë ekonomik është përdorur si arsye skualifikimi mosparaqitja e pajisjeve. Jo vetëm që faturat që dëshmojnë posedimin e këtyre pajisjeve janë paraqitur në SPE duke përmushur dhe tejkaluar numrin e kërkuar por KVO duhet të mbante në konsideratë faktin se dy operatorët ekonomikë pjesë e bashkimit të operatorëve ekonomikë kanë kapacitete të konsiderueshme ekonomike dhe teknike, kanë realizuar një numër të madh punimesh ndërtimore, kanë një periudhë të gjatë kohore që operojnë në treg dhe ndaj tyre nuk mund të përdoret arsye skualifikimi mosposedimi i pajisjeve ndihmëse. Për të vërtetuar edhe njëherë kapacitetet tona teknike ekonomike dhe financiare po ju paraqesim të gjitha faturat që janë dorëzuar bashkëlidhur DT si më poshtë.*
- *Faturë Blerje Nr.81 datë 02.05.2019 ku përfshihen Nivelues Betoni 1 copë Pompë suvatimi 6 copë*
- *Faturë Blerje nr.24 datë 23.12.2001 ku përfshihen Pompë Suvatimi 2 copë*
- *Faturë Blerje nr.14 datë 07.02.2016 ku përfshihen Gjenerator 1 copë*
- *Faturë Blerje Nr.2 datë 02.05.2008 ku përfshihen pompë suvatimi 1 copë*
- *Faturë Blerje Nr.164 datë 10.11.2007 ku përfshihen pompë suvatimi 1 copë*
- *Faturë Blerje Nr.162,164,165, dt 03.12.2006, 19.12.2006, 20.12.2006 ku përfshihen gjeneratorë 3 copë*
- *Faturë Blerje Nr.136 datë 03.03.2020 ku përfshihen Nivelues Betoni 4 copë*
- *Faturë Blerje Nr.18 dt 12.10.2001 ku përfshihen gjeneratorë 2 copë*

- *Faturë Blerje Nr. 104 datë 18.06.2013 ku përfshihen gjeneratorë 1 copë*
- *Faturë Blerje Nr.14 datë 07.02.2016 ku përfshihen gjeneratorë 1 copë*
- *Faturë Blerje Nr.378 datë 28.12.2016 ku përfshihen gjeneratorë 1 copë*
- *Faturë Blerje Nr.333 datë 12.12.2017 ku përfshihen gjeneratorë 1 copë*

*Lidhur me të gjitha argumentimet e sipërpërmendura kërkojmë një rivlerësim nga ana e AK duke e konsideruar të padrejtë vendimin e KVO dhe duke e kualifikuar ofertën e paraqitur nga BOE Dajti Park 2007 shpk & Glavenica shpk.*

- *Gjithashtu ju sjellim në vëmendje se në dijeninë tonë operatori ekonomik Aurora Konstruksion shpk i kualifikuar në më shumë se sa 1 lot nuk plotëson kapacitetet e kërkuara ligjore, financiare dhe teknike. Ju informojmë se deklarata e paraqitur nga ky operator ekonomik në lidhje me kontratat e lidhura apo në proces është e paplotë pasi nëse do ti referoheni buletineve të njoftimeve publike të APP do të rezultojnë kontrata të padeklaruar. Gjithashtu lidhur me kapacitetet njerëzore , stafi teknik dhe inxhinierik dhe kapacitetet teknike konkretisht makineritë nëse do të kryeni një shqyrtim do të arrini në konkluzionin që ato rezultojnë të angazhuara në kontratat të tjera.*
- *Kërkojmë nga ana juaj kualifikimin e ofertës sonë si dhe skualifikimin e shoqërisë Aurora Konstruksion shpk .*

II.14. Në datën 18.05.2020 me shkresën nr.1076/28 prot autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje BOE “Dajti Park 2007” shpk& “Glavenica” shpk ku ka vendosur mospranim e ankesës.

II.15. Në datën 27.05.2020 pala ankimuese BOE “Dajti Park 2007” shpk& “Glavenica” shpk ka dorëzuar ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjtin objekt ankese dorëzuar pranë autoritetit kontraktor.

II.16. Nëpërmjet shkresës nr.1076/35 prot datë 28.05.2020 protokolluar me tonën me nr.449/2 prot datë 29.05.2020, nr.449/3 prot datë 01.06.2020, nr.462/2 prot datë 04.06.2020 me objekt “*Dërgohet informacioni*”, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.17. Në datën 17.06.2020 Komisioni i Prokurimit Publik me vendimin KPP 211/2020 ka vendosur:

1. *Të mos marrë në shqyrtim themelin e ankesave të paraqitura nga BOE “Rafin Company” shpk& “Meteo” shpk, BOE “Dajti Park 2007” shpk& “Glavenica” shpk, “Kevin Konstruksion” shpk për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur”, me nr. REF-51811-02-27-2020 me objekt Loti 1 “Rikonstruksion i disa QSH- ve në qarqet Tiranë, Durrës, Dibër” me fond limit 131,310,315 lekë pa TVSH, zhvilluar në*

datën 30.03.2020 nga autoriteti kontraktor, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

2. Autoriteti kontraktor të pasqyrojë në SPE ofertat ekonomike të operatorëve ekonomikë pjesmarrës pas zbatimit të procedurave të përcaktuara në nenin 66 të VKM nr.914 datë 29.12.2014 i ndryshuar, lidhur me korigjimin e ofertave.
3. Autoriteti kontraktor brenda 10 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
4. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet për kthimin e tarifës financiare të paguar nga BOE “Rafin Company” shpk & “Meteo” shpk, BOE “Dajti Park 2007” shpk & “Glavenica” shpk, “Kevin Konstruksion” shpk
5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

II.18. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor rezulton se në datën 25.06.2020 autoriteti kontraktor në zbatimin të vendimit sa më sipër ka kryer rivlerësimin e procedurës dhe ka njoftuar operatorët ekonomikë mbi kualifikimin/skualifikimin e tyre si më poshtë:

Aurora Konstruksion	(oferte e korigjuar 93,509,729.9)	I kualifikuar
Dajti Park 2007&Glavenica	(oferte e korigjuar 97,083,501.5)	I skualifikuar
Rafin Company&Meteo	(ofertë e korigjuar 99,102,591)	I kualifikuar
Kevin Konstruksion	(oferte e korigjuar 99,737,860)	I skualifikuar
Sireta 2F	(oferte e korigjuar 99,982,575.83)	I kualifikuar
Almo Konstruksion&Ulza	(ofertë e korigjuar 101,572,856.96)	I skualifikuar
Company Riviera&Kacdedja	(ofertë e korigjuar 102,825,982.5)	I kualifikuar
BE-IS&Ergi	(ofertë e korigjuar 111,217,822.5)	I kualifikuar
Alko Impex& 2T	(ofertë e korigjuar 116,339,421.66)	I kualifikuar
Ante Group	(ofertë e korigjuar 123,722,538.25)	I kualifikuar

II.19. Në datën 29.06.2020 BOE “Rafin Company” shpk & “Meteo” shpk ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor në mënyrë të përmbledhur me argumentat si më poshtë:

- Nuk jemi dakord me vlerësimin e bërë nga ana e KVO pasi shoqëria Aurora Konstruksion është kualifikuar në kundërshtim me ligjin dhe rregullat e prokurimit publik me pretendimin si më poshtë:
- Pretendimi i parë: Në gjykimin tonë pjesmarrja e operatorit ekonomik Aurora Konstruksion në të gjitha lotet objekt prokurimi është haptazi në shkelje ligjore. Operatori ekonomik Aurora Konstruksion shpk është kualifikuar në kundërshtim me ligjin dhe rregullat e prokurimit publik pasi nuk përmbush kapacitetet për të ekzekutuar kontratat.

- Sqarojmë se referuar nenit 9 të VKM nr.914 datë 29.12.2014 i ndryshuar pika 5: Kontrata ndahet në lote, kur përbëhet nga punë, mallra apo shërbime, homogjene ose të ngjashme, dhe kur vlera e kombinuar është e tillë që vetëm një numër i kufizuar operatorësh ekonomikë do të ishin në gjendje t'i siguronin ato. Kjo mënyrë mund të përdoret veçanërisht për të nxitur pjesëmarrjen e biznesit të vogël e të mesëm dhe për të ulur kostot administrative të autoritetit kontraktor.
- Neni 74 i VKM së sipërcituar parashikon: Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe në rast përzgjedhjeje edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi.
- 2. Para dorëzimit të ofertës, bashkimi duhet të krijohet zyrtarisht, me një marrëveshje të noterizuar, ku të përcaktohen përfaqësuesi i grupit, përqindja e pjesëmarrjes së punës/shërbimit/furnizimit dhe elementet konkrete, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi. Pas krijimit të bashkimit të operatorëve ekonomikë, anëtarët e bashkimit caktojnë me procure përfaqësuesin e tyre për dorëzimin e ofertës. Kjo marrëveshje e shkruar dhe prokura duhet të dërgohen së bashku me kualifikimet dhe ofertën ekonomike, e cila duhet të nënshkruhet nga përfaqësuesi. Përfaqësuesi duhet të bëjë edhe sigurimin e ofertës, nëse kërkohet, duke specifikuar pjesëmarrjen në bashkimin e operatorëve ekonomikë. Në rast se bashkimi i operatorëve ekonomikë shpallet fitues, kontrata duhet të nënshkruhet nga secili prej anëtarëve të këtij bashkimi.
- 3. Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat ligjore, të parashikuara në nenin 45 të LPP dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në akt marrëveshje.
- Sa më sipër për sa kohë që në mënyrë specifike *lex specialis*, LPP dhe aktet nënligjore në zbatim të tij kërkojnë në mënyrë të shprehur se: Kërkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në akt marrëveshje.
- Pra në kuptim të ligjit të posacëm jo vetëm kërkohet në mënyrë eksplicite që kërkesat duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi por edhe në përputhje me formën e parashikuar në ligj me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim të përcaktuara në akt marrëveshje.
- Lidhur me këtë pikë nga interpretimi literal i neneve sa më sipër kriteret në të gjitha lotet janë kumulative të vecanta dhe duhet të plotësohen në mënyrë të specifikuar sipas të gjitha kërkesave të përcaktuara në shtojcën 12 të DT kriteret të vecanta. Rrjedhimisht operatorët ekonomikë të interesuar dhe pjesëmarrës duhet të përmbushin e plotësojnë të gjithë kapacitetet teknike, ekonomike, financiare dhe kualifikimin profesional. Dyshojmë që operatori ekonomik Aurora Konstruksion shpk (pjesëmarrëse në të gjitha lotet) të plotësojë kërkesat e përcaktuara dhe kërkuara në mënyrë eksplicite në gjithë procedurat në të cilat është anagazhuar

*JV me operatorë të tjerë. Pra rrjedhimisht jo vetëm që nuk janë përmbushur kërkesat dhe bashkimi në formën e kërkuar nga ligji por edhe nuk disponohen kapacitetet për të ekzekutuar procedurën.*

- *Në shtojcën 12 të DT është përcaktuar qartësisht: Pjesmarrja në më shumë se një Lot*
- *Nese nje operator ekonomik konkuron ne me shume se 1 lot te kesaj procedure prokurimi ateherë ai duhet te zoteroje kapacitetet teknike, ekonomike financiare dhe kualifikimin profesional per te realizuar objektin e procedures se prokurimit, pra te gjitha loteve se bashku. Ne kete kuptim edhe kriteret e vecanta per kualifikim (si psh kategorite e licensave, nr. i punonjesve dhe mjeteve , kontratat e ngjashme, xhiro., etj) duhet te plotesohen nga operatori ekonomik ne varesi te loteve qe ai konkuron.*
- *Referuar nenit 26 pika 7/d te RRPP vleresimi mbi kategorite e licences, do te behet me radhe per secilin lot, duke pasur parasysh qe vlera e punimeve qe ka ofertuesi ne proces (perfshire lotin/lotet per te cilet eshte mbyllur vleresimi dhe eshte shpallur fitues ne kete procedure) nuk tejkalon vleren e punimeve sipas kategorive te licences profesionale te ofertuesit.*
- *Persa i takon licensave, te kihet parasysh qe sipas loteve ku oferton te paraqese kategorite e licensave sipas tabelës së mëposhtme:*

<b>kombinim lotesh</b>	<b>PUNIM E Germimi NP1</b>	<b>Rikonstruksi on dhe mirembajtje godinash civ&amp;industr , veshje godinash NP3</b>	<b>NS.2 - Impiante hidrosanitare, etj</b>	<b>NS.12 - Impiante teknologjike , termike dhe te kondicionimit</b>	<b>NS.14 - Impiante te brendshme elektrike, telefonike, radiotelefoni, TV,</b>
<b>LOT 1+LOT 2</b>	A	E	B	A	B
<b>LOT 1+LOT 3</b>	A	D	B	A	B
<b>LOT 1+LOT 4</b>	A	D	B	A	B
<b>LOT 2+LOT 3</b>	A	E	B	A	B



<b>LOT 2+LOT 4</b>	A	E	B	A	B
<b>LOT 3+LOT 4</b>	A	D	B	A	B
<b>LOT 1+LOT 2+LOT 3</b>	A	E	B	A	B
<b>LOT 1+LOT 2+LOT 4</b>	A	E	B	A	B
<b>LOT 1+LOT 3+LOT 4</b>	A	E	B	A	B
<b>LOT 2+LOT 3+LOT 4</b>	A	E	B	A	B
<b>LOT 1+LOT 2+LOT 3+LOT 4</b>	A	F	C	A	B

- Nëse një operator ekonomik konkuron në më shumë se 1 lot të kësaj procedure prokurimi atëherë ai duhet të zotërojë kapacitetet teknike, ekonomike financiare dhe kualifikimin profesional për të realizuar objektin e procedurës së prokurimit pra të gjitha loteve së bashku. Në këtë kuptim edhe kriteret e vecanta për kualifikim (si psh kategoritë e licencave, numri i punonjësve dhe mjeteve, kontratat e ngjashme, xhiro etj) duhet të plotësohen nga operatori ekonomik në varësi të loteve që ai konkuron.
- Në rastin konkret operatori ekonomik Aurora Konstruksion është pjesëmarrëse në të gjitha lotet. Pra sa i takon aftësive teknike, profesionale, mjete etj gjykojmë se ndarja e një procedure prokurimi në lote realizohet atherë kur vetë kontrata përbëhet nga punë, mallra apo shërbime, homogjene ose të ngjashme.
- Në gjykimin tonë në rast se operatorët ekonomikë janë pjesëmarrës në të gjitha lotet e procedurës së prokurimit atherë kjo do të jetë e njëvlefshme me marrjen pjesë në të gjithë procedurën e prokurimit dhe shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave në përputhje me kërkesën e autoritetit kontraktor në drejtim të plotësimit të kapacitetit të tij teknik duhet të jetë në përputhje me kërkesën e autoritetit kontraktor për të gjitha lotet së bashku për sa kohë që qëllimi final i operatorit ekonomik i shfaqur përmes angazhimit të tij të deklaruar për të qenë një fitues potencial i të gjithë procedurës së prokurimit (të gjithë loteve të vecanta) atherë ky i fundit duhet të dëshmojë se plotëson kapacitetin e tij ekonomik për të gjithë

grup lotet ku ka marrë pjesë në përputhje me kërkesën e autoritetit kontraktor dhe në interpretim të zgjeruar të parashikimeve ligjore të LPP dhe akteve të tjera ligjore.

- Së dyti në shtojcën 12 pika 2.3.2 është vendosur kriteri kualifikues si më poshtë:

### **2.3.2 Përvojë e suksesshme në realizimin e të paktën:**

- c.** Punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë prej 50% të fondit limit të këtij loti, të realizuar gjatë tri viteve të fundit. (3 vitet e fundit nga data e zhvillimit të procedurës së prokurimit të këtij loti ).
- d.** Punë të ngjashme deri në një kufi ku vlera monetare totale e punëve të kryera e marrë së bashku gjatë tre viteve të fundit është sa dyfishi i fondit limit të këtij loti (realizuar gjatë 3 viteve të fundit nga data e zhvillimit të procedurës së prokurimit të këtij loti ).

**Plotesimi i njerit prej dy kushteve të sipërpermendura e ben oferten te kualifikueshme.**

\*Kur konkurohet për më shumë se një lot vlera e kërkuar do të jetë:

**a.** Në masën 50% të fondit limit të shumës së loteve për të cilat konkurron.

**b.** Sa dyfishi i fondit limit të shumës së loteve për të cilat konkurron.

Operatori ekonomik Aurora Konstruksion është kualifikuar në kundërshtim me ligjin dhe rregullat e prokurimit publik pasi nuk plotëson kriterin e sipërpermendur për punë të ngjashme sepse kontratat e ngjashme të paraqitura prej tij nuk plotësojnë vlerën e kërkuar në kriterin e përcaktuar në pikën 2.3.2 dhe konkretisht pjesën e kriterit Kur konkurohet për më shumë se një lot vlera e kërkuar do të jetë:

**a.** Në masën 50% të fondit limit të shumës së loteve për të cilat konkurron.

**b.** Sa dyfishi i fondit limit të shumës së loteve për të cilat konkurron.

Nga informacioni që kemi ky operator ka qenë pjesëmarrës dhe është kualifikuar në të 4 lotet e publikuara nga autoriteti kontraktor , informacion të cilin e përforcon edhe Njoftimi i skualifikimit i publikuar nga autoriteti kontraktor më datë 05.05.2020 (ku për operatorin ekonomik Aurora Konstruksion është bërë shënim: Operatori ekonomik kualifikohet por nuk mund të shpallet fitues në më shumë se një lot se kapacitetet e tij pasi sipas sqarimit të NjP ngarkuar në SPE).

- Lidhur me pikën 2.3.7.
- 2.3.7 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të deklarojë inxhinierin e ndertimit, inxhinierin h/teknik ose mekanik dhe elektrik që do të jënë në kantier sipas grafikut të punimeve:

- Per qarkun Tirane: 2 inxh.ndertimi; 1 inxh h/teknik ose mekanik dhe 1 inxh.elektrik.
- Per qarkun Durres: 1 inxh.ndertimi; 1 inxh h/teknik ose mekanik dhe 1 inxh.elektrik.
- Per qarkun Diber: 1 inxh ndertimi, 1 inxh elektrik dhe 1 inxh.h/teknik/mekanik
- Per sejcilin prej ketyre inxhinierëve të kantierit sipas pikës 4.1 duhet të paraqiten kontratat e punës brenda afatit të vlefshmerisë së këtij objekti, diplomat dhe cv.
- Mbështetur në kriteret e përcaktuara në DT përvojën që kemi në fushën e prokurimeve publike kemi bindjen se ofertuesi Aurora Konstruksion nuk plotëson kërkesën e përcaktuar në pikën 2.3.7 të DT pasi kontratat e dorëzuara për inxhinierin e ndërtimit, inxh h/teknik ose mekanik dhe elektrik që do të jenë në kantier për qarqet Durrës, Tiranë dhe Dibër pasi dyshojmë që nuk janë të rregullt nga ana formale (ku përfshihet nënshkrimi nga palët) nuk janë brenda afatit të vlefshëmrisë së objektit të prokurimit si dhe nuk janë të siguruar në listpagesat e shoqërisë për periudhën shtator 2019-shkurt 2020.
- Pika 2.3.8. 2.3.8. Të ketë në stafin e punonjësve të pasqyruar në list pagesa punonjës të pajisur me deshmë kualifikimi të sigurimit teknik nga IQT ose ekuivalente me të, të vlefshme: 5 (pese) punonjës elektrikist; 5 (pese) punonjës hidraulik/mekanik; 4(kater) punonjës murator; 3 (tre) punonjës pllakashtrues; 3 (tre) punonjës bojaxhi; 2 (dy) saldatore. Per punonjesit e siperpermendur te paraqiten deshmitë perkatëse te kualifikimit te sigurimit teknik si dhe kontrata e punes (te vlefshme). Mbështetur në kriteret e përcaktuara në DT përvojën që kemi në fushën e prokurimeve publike kemi bindjen se ofertuesi Aurora Konstruksion nuk plotëson kërkesën e përcaktuar në pikën 2.3.8 lidhur me disponimin nga ana e tij të 5 punonjësve hidraulik/mekanik dhe 5 punonjës elektrikist pasi punonjësit e sipërpërmendur nuk janë të siguruar me kodet përkatëse sipas VKM nr.514 datë 20.09.2017 Për listën kombëtare të profesioneve.
- Pika 2.3.6. Operatorët ekonomike pjesëmarrës duhet të kenë drejtues teknik të punësuar për periudhën e kërkuar **Shtator 2019- Shkurt 2020** të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, CV:
  - Inxhinier Ndërtimi
  - Inxhinier Mekanik ose H/teknik
  - Inxhinier Elektrik

Mbështetur në kriteret e përcaktuara në DT, përvojën që kemi në fushën e prokurimeve publike kemi bindjen se ofertuesi Aurora Konstruksion nuk plotëson kërkesën e përcaktuar në pikën 2.3.6 pasi drejtuesit teknik të kërkuar nuk janë të siguruar me kohë të plotë për periudhën shtator 2019-shkurt 2020 sikurse parashikon VKM nr.41 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimii ndryshuar.

*Pra në mënyrë të përmbledhur nënvizojmë faktin se në vlerësimin e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë pjesmarrës në procedurat e prokurimit të ndarë në lote, në rast se operatori ekonomik Aurora Konstruksion referuar informacioneve tona shfaqet në cilësinë e subjektit pjesmarrës në të gjitha lotet si edhe në kushtet e parashikimit në vetë dokumentat e procedurës së prokurimit, ku në rast se një operator ekonomik apo bashkim operatorësh që konkuron për dy ose më shumë lote tek kriteret e vecanta të kualifikimit përcaktohet ai duhet të ai duhet të zotërojë kapacitetet teknike, ekonomike financiare dhe kualifikimin profesional për të realizuar objektin e procedurës së prokurimit pra të gjitha loteve së bashku. Në këtë kuptim edhe kriteret e vecanta për kualifikim (si psh kategoritë e licencave, numri i punonjësve dhe mjeteve, kontratat e ngjashme, xhiro etj.*

*Pra duhet të plotësohen në përputhje me vlerën e përlllogaritur të kontratës/ si shumë aritmetike e kapaciteteve të kërkuara për cdo lot pra autoriteti kontraktor duhet ti referohet vlerësimin të kriterëve në përputhje me grupin e loteve të procedurës së prokurimit ku subjekti shfaqet në cilësinë e operatorit ekonomik pjesmarrës . Në rastin konkret operatori ekonomik Aurora Konstruksion nuk plotëson pikën 2.3.5 numri i punonjësve , 2.3.6 stafi inxhinjerik, 2.3.7 ndarjen e inxhinjerëve sipas qarqeve për të gjitha lotet , 2.3.8 punonjësit e specializuar, 2.3.10 mjetet. Për referencë citojmë përgjigjen e dhënë nga ana juaj në sistem kërkesave për sqarim e cila qartazi saktëson që kapacitetet duhet të jenë të vecanta dhe të ndara sipas qarqeve rrjedhimisht edhe sipas loteve.*

- *Pretendimi nr.2:*
- *Mbetjen të skualifikuar të ofertës së shoqërisë Dajti Park si ofertë ekonomike me gabime aritmetike mbi 2%.*
- *Në shtojcën 12 pika 2.3.8. Të ketë në stafin e punonjesve te pasqyruar ne list pagesa punonjës të pajisur me deshmi kualifikimi te sigurimit teknik nga IQT ose ekuivalente me te, të vlefshme: 5 (pese) punonjës elektrikist; 5 (pese) punonjës hidraulik/mekanik; 4(kater) punonjës murator; 3 (tre) punonjës pllakashtrues; 3 (tre) punonjes bojaxhi; 2 (dy) saldatore. Per punonjesit e siperpermendur te paraqiten deshmitë perkatese te kualifikimit te sigurimit teknik si dhe kontrata e punes (te vlefshme). Mbështetur në kriteret e përcaktuara në DT përvojën që kemi në fushën e prokurimeve publike kërkojmë shtimin e arsyeve të skualifikimit për ofertuesin Dajti Park pasi nuk plotëson kërkesën e përcaktuar në pikën 2.3.8 lidhur me disponimin nga ana e tij të 5 punonjësve hidraulik/mekanik 3 punonjës bojaxhi dhe 5 punonjës elektrikist pasi punonjësit e sipërpërmendur nuk janë të siguruar me kodet përkatëse sipas VKM nr.514 datë 20.09.2017 Për listën kombëtare të profesioneve.*
- *Pretendim nr.3: Mbetjen të skualifikuar të ofertës së shoqërisë Kevin Konstruksion përveç arsyes si më poshtë: Sipas formularit të ofertës të paraqitur nga OE vlera e deklaruar 88,877,686 lekë pa tvsh nuk përfshin fare vlerën e*

*pajisjeve. Sa më sipër deklarimi i ofertës nga OE është bërë gabim nuk përputhet me kërkesën e AK pasi nuk përfshin pajisjet.*

- *Mbështetur në kriteret e përcaktuara në DT përvojën që kemi në fushën e prokurimeve publike kërkojmë shtimin e arsyeve të skualifikimit për ofertuesin Kevin Konstruksion pasi nuk plotëson kërkesën e përcaltuar në pikën 2.3.8 lidhur me disponimin nga ana e tij të 5 punonjësve hidraulik/mekanik, 3 punonjës bojaxhi dhe 5 punonjës elektrikist pasi punonjësit e sipërpërmendur nuk janë të siguruar me kodet përkatëse me kodet përkatëse sipas VKM nr.514 datë 20.09.2017 Për listën kombëtare të profesioneve. Gjithashtu OE Kevin Construction shpk nuk ka përmbushur pikën mjete tip eskavator me goma ose zinxhir 0.25 m3 pasi nga çfarë kemi lexuar në buletine të pasqyruara në APP eskavatori i tij është i një kapaciteti germues shumë më të lartë nga kapaciteti i kërkuar dhe konsiderohen jo të përshtatshme dhe përtej kapacitetit të kërkuar.*
- *Sugjerojmë AK ti referohet për interpretim të drejtë edhe parashikimeve të nenit 58 kriteret e përzgjedhjes të direktivës 24/2014 të PE dhe të KE për Prokurimin Publik ku në një rast analog referuar kriterve të vecanta të kualifikimit parashikohet se Kur kontrata është e ndarë në lote ky nen do të zbarohet në lidhje për secilin lot . Megjithatë autoriteti kontraktues mund të vendosë minimumin e qarkullimit vjetor që operatorët ekonomikë janë të detyruar të paraqesin duke ju referuar grupeve të secilit lot në rast se ofertuesi i suksesshëm do të lidhë kontrata në disa lote në të njëjtën kohë.*
- *Sa më sipër kuadri ligjor në fushën e prokurimeve parë kjo edhe në interpretim të Direktivës 24/2014 të PE dhe të Këshillit Për Prokurimin Publik jep mundësinë autoritetit kontraktor të parashikojë se në rast se operatorët ekonomikë pjesmarrës shfaqen në cilësinë e ofertuesit në disa grup lotesh në procedurën e prokurimit atëherë gjykimi i kapacitetit të tyre do të kryhet në tërësi referuar kërkesës së autoritetit kontraktor për të gjitha lotet e procedurës së prokurimit objekt ankimi.*
- *Sa më sipër kërkojmë rivlerësimin e procedurës së prokurimit duke skualifikuar ofertën e shoqërisë Aurora Konstruksion si dhe mbetjen të skualifikuar Dajti Park dhe mbetjen & shtimin e arsyeve të skualifikimit për shoqërinë Kevin Konstruksion pasi nuk kanë plotësuar kërkesat për kualifikim të dhëna në DT.*

II.20. Në datën 07.07.2020 me shkresën nr.1076/54 prot autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje BOE “Rafin Company” shpk& “Meteo” shpk ku ka vendosur mospranim e ankesës.

II.21. Në datën 13.07.2020 pala ankimuese BOE “Rafin Company” shpk& “Meteo” shpk ka dorëzuar ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjtin objekt ankesë dorëzuar pranë autoritetit kontraktor.

II.22. Nëpërmjet shkresës nr.1076/61 prot datë 21.07.2020 protokolluar me tonën me nr.744/2 prot datë 24.07.2020, me objekt “Dërgohet informacioni”, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit.

### III

#### Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesave, dokumentacionit bashkëngjitur, dokumentave të dërguara nga autoriteti kontraktor,

#### Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Rafin Company” shpk& “Meteo” shpk mbi kualifikimin e operatorit ekonomik Aurora Konstruksion me argumentet se *Nuk jemi dakord me vlerësimin e bërë nga ana e KVO pasi shoqëria Aurora Konstruksion është kualifikuar në kundërshtim me ligjin dhe rregullat e prokurimit publik me pretendimin si më poshtë:*

*Pretendimi i parë: Në gjykimin tonë pjesmarrja e operatorit ekonomik Aurora Konstruksion në të gjitha lotet objekt prokurimi është haptazi në shkelje ligjore. Operatori ekonomik Aurora Konstruksion shpk është kualifikuar në kundërshtim me ligjin dhe rregullat e prokurimit publik pasi nuk përmbush kapacitetet për të ekzekutuar kontratat.*

*Sqarojmë se referuar nenit 9 të VKM nr.914 datë 29.12.2014 i ndryshuar pika 5: Kontrata ndahet në lote, kur përbëhet nga punë, mallra apo shërbime, homogjene ose të ngjashme, dhe kur vlera e kombinuar është e tillë që vetëm një numër i kufizuar operatorësh ekonomikë do të ishin në gjendje t'i siguronin ato. Kjo mënyrë mund të përdoret veçanërisht për të nxitur pjesëmarrjen e biznesit të vogël e të mesëm dhe për të ulur kostot administrative të autoritetit kontraktor.*

*Neni 74 i VKM së sipërcituar parashikon: Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe në rast përzgjedhjeje edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi.*

*2. Para dorëzimit të ofertës, bashkimi duhet të krijohet zyrtarisht, me një marrëveshje të noterizuar, ku të përcaktohen përfaqësuesi i grupit, përqindja e pjesëmarrjes së punës/shërbimit/furnizimit dhe elementet konkrete, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi. Pas krijimit të bashkimit të operatorëve ekonomikë, anëtarët e bashkimit caktojnë*

me procure përfaqësuesin e tyre për dorëzimin e ofertës. Kjo marrëveshje e shkruar dhe prokura duhet të dërgohen së bashku me kualifikimet dhe ofertën ekonomike, e cila duhet të nënshkruhet nga përfaqësuesi. Përfaqësuesi duhet të bëjë edhe sigurimin e ofertës, nëse kërkohet, duke specifikuar pjesëmarrjen nëbashkimin e operatorëve ekonomikë. Në rast se bashkimi i operatorëve ekonomikë shpallet fitues, kontrata duhet të nënshkruhet nga secili prej anëtarëve të këtij bashkimi.

3. Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat ligjore, të parashikuara në nenin 45 të LPP dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në akt marrëveshje.

Sa më sipër për sa kohë që në mënyrë specifike *lex specialis*, LPP dhe aktet nënligjore në zbatim të tij kërkojnë në mënyrë të shprehur se: Kërkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në akt marrëveshje.

Pra në kuptim të ligjit të posacëm jo vetëm kërkohet në mënyrë eksplicite që kërkesat duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi por edhe në përputhje me formën e parashikuar në ligj me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim të përcaktuara në akt marrëveshje.

Lidhur me këtë pikë nga interpretimi literal i neneve sa më sipër kriteret në të gjitha lotet janë kumulative të vecanta dhe duhet të plotësohen në mënyrë të specifikuar sipas të gjitha kërkesave të përcaktuara në shtojcën 12 të DT kriteret të vecanta. Rrjedhimisht operatorët ekonomikë të interesuar dhe pjesëmarrës duhet të përmbushin e plotësojnë të gjithë kapacitetet teknike, ekonomike, financiare dhe kualifikimin profesional. Dyshojmë që operatori ekonomik Aurora Konstruksion shpk (pjesëmarrëse në të gjitha lotet) të plotësojë kërkesat e përcaktuara dhe kërkua në mënyrë eksplicite në gjithë procedurat në të cilat është anagazhuar JV me operatorë të tjerë. Pra rrjedhimisht jo vetëm që nuk janë përmbushur kërkesat dhe bashkimi në formën e kërkuar nga ligji por edhe nuk disponohen kapacitetet për të ekzekutuar procedurën.

Në shtojcën 12 të DT është përcaktuar qartësisht: Pjesëmarrja në më shumë se një Lot

Nese nje operator ekonomik konkurron ne me shume se **1 lot** te kesaj procedure prokurimi atehere ai duhet te zoteroje kapacitetet teknike, ekonomike financiare dhe kualifikimin profesional per te realizuar objektin e procedures se prokurimit, pra te gjitha loteve se bashku. Ne kete kuptim edhe kriteret e vecanta per kualifikim (si psh kategorite e licensave, nr. i punonjesve dhe mjeteve , kontratat e ngjashme, xhiro., etj) duhet te plotesohen nga operatori ekonomik ne varesi te loteve qe ai konkurron.

Referuar nenit 26 pika 7/d te RRPP vleresimi mbi kategorite e licences, do te behet me radhe per secilin lot, duke pasur parasysh qe vlera e punimeve qe ka ofertuesi ne proces (perfshire lotin/lotet per te cilet eshte mbyllur vleresimi dhe eshte shpallur fitues ne kete procedure) nuk tejkalon vleren e punimeve sipas kategorive te licences profesionale te ofertuesit.

Persa i takon licencave, te kihet parasysh qe sipas loteve ku oferton te paraqese kategorite e licencave sipas tabelës së mëposhtme:

<b>kombinim lotesh</b>	<b>PUNIM E Germim i NP1</b>	<b>Rikonstruksi on dhe mirembajtje godinash civ&amp;industr , veshje godinash NP3</b>	<b>NS.2 - Impiante hidrosanitar e, etj</b>	<b>NS.12 - Impiante teknologjike , termike dhe te kondicionim it</b>	<b>NS.14 - Impiante te brendshme elektrike, telefonike, radiotelefon i, TV,</b>
<b>LOT 1+LOT 2</b>	A	E	B	A	B
<b>LOT 1+LOT 3</b>	A	D	B	A	B
<b>LOT 1+LOT 4</b>	A	D	B	A	B
<b>LOT 2+LOT 3</b>	A	E	B	A	B
<b>LOT 2+LOT 4</b>	A	E	B	A	B
<b>LOT 3+LOT 4</b>	A	D	B	A	B
<b>LOT 1+LOT 2+LOT 3</b>	A	E	B	A	B
<b>LOT 1+LOT 2+ LOT4</b>	A	E	B	A	B



<b>LOT 1+LOT 3+ LOT4</b>	A	E	B	A	B
<b>LOT 2+LOT 3+ LOT4</b>	A	E	B	A	B
<b>LOT 1+LOT 2+ LOT3 +LOT 4</b>	A	F	C	A	B

*Nëse një operator ekonomik konkuron në më shumë se 1 lot të kësaj procedure prokurimi atëherë ai duhet të zotërojë kapacitetet teknike, ekonomike financiare dhe kualifikimin profesional për të realizuar objektin e procedurës së prokurimit pra të gjitha loteve së bashku. Në këtë kuptim edhe kriteret e vecanta për kualifikim (si psh kategoritë e licencave, numri i punonjësve dhe mjeteve, kontratat e ngjashme, xhiro etj) duhet të plotësohen nga operatori ekonomik në varësi të loteve që ai konkuron.*

*Në rastin konkret operatori ekonomik Aurora Konstruksion është pjesmarrëse në të gjitha lotet. Pra sa i takon aftësive teknike, profesionale, mjete etj gjykojmë se ndarja e një procedure prokurimi në lote realizohet atherë kur vetë kontrata përbëhet nga punë, mallra apo shërbime, homogjene ose të ngjashme.*

*Në gjykimin tonë në rast se operatorët ekonomikë janë pjesmarrës në të gjitha lotet e procedurës së prokurimit atherë kjo do të jetë e njëvlefshme me marrjen pjesë në të gjithë procedurën e prokurimit dhe shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave në përputhje me kërkesën e autoritetit kontraktor në drejtim të plotësimi të kapacitetit të tij teknik duhet të jetë në përputhje me kërkesën e autoritetit kontraktor për të gjitha lotet së bashku për sa kohë që qëllimi final i operatorit ekonomik i shfaqur përmes angazhimit të tij të deklaruar për të qenë një fitues potencial i të gjithë procedurës së prokurimit (të gjithë loteve të vecanta) atherë ky i fundit duhet të dëshmojë se plotëson kapacitetin e tij ekonomik për të gjithë grup lotet ku ka marrë pjesë në përputhje me kërkesën e autoritetit kontraktor dhe në interpretim të zgjeruar të parashikimeve ligjore të LPP dhe akteve të tjera ligjore,  
Së dyti në shtojcën 12 pika 2.3.2 është vendosur kriteri kualifikues si më poshtë:*

### **2.3.3 Përvojë e suksesshme në realizimin e të paktën:**

- e. Punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë prej 50% të fondit limit të këtij loti, të realizuar gjatë tri viteve të fundit. (3 vitet e fundit nga data e zhvillimit te procedures se prokurimit te ketij loti ).*

f. Punë të ngjashme deri ne nje kufi ku vlera monetare totale e punëve të kryera e marrë së bashku gjatë tre viteve të fundit është sa dyfishi i fondit limit të këtij loti (realizuar gjatë 3 viteve të fundit nga data e zhvillimit te procedures se prokurimit te ketij loti ).

**Plotesimi i njerit prej dy kushteve te siperpermendura e ben oferten te kualifikueshme.**

\*Kur konkurohet për më shumë se një lot vlera e kërkuar do të jetë:

a. Në masën 50% të fondit limit të shumës së loteve për të cilat konkurron.

b.Sa dyfishi i fondit limit të shumës së loteve për të cilat konkurron.

Operatori ekonomik Aurora Konstruksion është kualifikuar në kundërshtim me ligjin dhe rregullat e prokurimit publik pasi nuk plotëson kriterin e sipërpërmendur për punë të ngjashme sepse kontratat e ngjashme të paraqitura prej tij nuk plotësojnë vlerën e kërkuar në kriterin e përcaktuar në pikën 2.3.2 dhe konkretisht pjesën e kriterit Kur konkurohet për më shumë se një lot vlera e kërkuar do të jetë:

a. Në masën 50% të fondit limit të shumës së loteve për të cilat konkurron.

b.Sa dyfishi i fondit limit të shumës së loteve për të cilat konkurron.

Nga informacioni që kemi ky operator ka qenë pjesmarrës dhe është kualifikuar në të 4 lotet e publikuara nga autoriteti kontraktor , informacion të cilin e përforcon edhe Njoftimi i skualifikimit i publikuar nga autoriteti kontraktor më datë 05.05.2020 (ku për operatorin ekonomik Aurora Konstruksion është bërë shënimi: Operatori ekonomik kualifikohet por nuk mund të shpallet fitues në më shumë se një lot se kapacitetet e tij pasi sipas sqarimit të NjP ngarkuar në SPE)”,

Pra në mënyrë të përmbledhur nënvizojmë faktin se në vlerësimin e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë pjesmarrës në procedurat e prokurimit të ndarë në lote, në rast se operatori ekonomik Aurora Konstruksion referuar informacioneve tona shfaqet në cilësinë e subjektit pjesmarrës në të gjitha lotet si edhe në kushtet e parashikimit në vetë dokumentat e procedurës së prokurimit, ku në rast se një operator ekonomik apo bashkim operatorësh që konkurron për dy ose më shumë lote tek kriteret e vecanta të kualifikimit përcaktohet ai duhet të ai duhet të zotërojë kapacitetet teknike, ekonomike financiare dhe kualifikimin profesional për të realizuar objektin e procedurës së prokurimit pra të gjitha loteve së bashku. Në këtë kuptim edhe kriteret e vecanta për kualifikim (si psh kategoritë e licencave, numri i punonjësve dhe mjeteve, kontratat e ngjashme, xhiro etj.

Pra duhet të plotësohen në përputhje me vlerën e përlllogaritur të kontratës/ si shumë aritmetike e kapaciteteve të kërkuara për cdo lot pra autoriteti kontraktor duhet ti referohet vlerësimit të kriterëve në përputhje me grupin e loteve të procedurës së prokurimit ku subjekti shfaqet në cilësinë e operatorit ekonomik pjesmarrës . Në rastin konkret operatori ekonomik Aurora Konstruksion nuk plotëson pikën 2.3.5 numri i punonjësve , 2.3.6 stafi inxhinjerik, 2.3.7 ndarjen e inxhinierëve sipas qarqeve për të gjitha lotet , 2.3.8 punonjësit e specializuar, 2.3.10 mjetet. Për referencë citojmë përgjigjen e dhënë nga ana juaj në sistem kërkesave për sqarim e cila qartazi saktëson që kapacitetet duhet të jenë të vecanta dhe të ndara sipas qarqeve rrjedhimisht edhe sipas loteve”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren,

III.1.1. Para shqyrtimit në themel të pretendimeve të operatorëve ekonomikë ankimues, (thema decidendum) në zbatim të nenit 64 pika 3 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” të ndryshuar, parashikohet se: “3. Përpara lidhjes së kontratës, Komisioni i Prokurimit Publik, kur gjykon se një vendim apo veprim i autoritetit kontraktor ka shkelur ndonjë nga dispozitat e këtij ligji, ka të drejtë:

a) të nxjerrë një interpretim për rregullat ose parimet ligjore, që duhet të zbatohen për objektin e ankesës;

b) të anulojë, plotësisht ose pjesërisht, një veprim ose vendim të autoritetit kontraktor, të nxjerrë në kundërshtim me ligjin. Kjo përfshin edhe të drejtën për të hequr të gjitha ato specifikime teknike ose llojet e tjera të specifikimeve që bien ndesh me këtë ligj;

c) të udhëzojë autoritetin kontraktor të korrigjojë shkeljet dhe më pas të vazhdojë me procedurën e prokurimit të kontratës;

ç) të urdhërojë anulimin e procedurave për shpalljen e kontratës fituese”.

Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se, referuar parashtrimeve me shkrim të operatorit ekonomik ankimues, ky i fundit, referuar ankesës së dorëzuar pranë autoritetit kontraktor dhe më pas pranë Komisionit të Prokurimit Publik ka parashtruar pretendime në lidhje me mospërbushjen e kriterëve të vecanta të kualifikimit në lotin e procedurës së prokurimit të ankimuar duke e lidhur këtë të fundin me kualifikimin e po të njëjtit operator ekonomik edhe në lotet e tjera të procedurës së prokurimit duke ngritur pretendime se *ipso facto*- fakti që operatori ekonomik është kualifikuar në lotet e tjera të procedurës së prokurimit nuk përmbush kriterin/et e vecanta të kualifikimit si vlerësim kumulativ i tyre në procedurën konkrete të prokurimit ( ipso legge). Në rastin konkret, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se para shqyrtimit në themel të pretendimeve të bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues në lidhje me pretendimet e mësipërme të ndalet fillimisht në legjitimitimin e palës për kërkimin e mësipërm. Në nenin 63 pika 1.1 dhe 2 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” të ndryshuar, parashikohet se: “1. Çdo person, që ka ose ka pasur interes në një procedurë prokurimi dhe kur është dëmtuar ose rrezikohet të dëmtohet nga një vendim i autoritetit kontraktor, i marrë në kundërshtim me këtë ligj, mund ta kundërshtojë vendimin. 2. Ankesa kundër vendimeve të autoritetit kontraktor i paraqitet, së pari, me shkrim, autoritetit kontraktor në fjalë brenda 7 ditëve nga dita e nesërme e punës kur ankimuesi është vënë në dijeni ose duhet të ishte vënë në dijeni për shkeljen e pretenduar, sipas këtij ligji.” Gjithashtu, ligjvënësi ka parashikuar edhe rregulla strikt mbi procedurën e shqyrtimit të ankesave si nga autoriteti kontraktor ashtu edhe nga Komisioni i Prokurimit Publik, në cilësinë e organit më të lartë të shqyrtimit të ankesave në fushën e prokurimeve publike, në zbatim edhe të nenit 19/1 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” të ndryshuar. Kështu, ligjvënësi ka paraparë, se ankesa pranë Komisionit të Prokurimit Publik bëhet kundrejt pagesës. Rregullat dhe tarifat e pagesës përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave ( neni 63 pika 10). Ndërkohë, në nenin 1,2,3 dhe 4 të Vendimit nr.216 datë 17.03.2010 të Këshillit të Ministrave “ Për Përcaktimin e Tarifës dhe të Rregullave për Pagimin e saj, në një Procedurë Ankimimi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, parashikohet se: “1.Ankesa e paraqitur në rrugë elektronike, pranë Komisionit të Prokurimit Publik (KPP), nga çdo person që ka ose ka pasur një interes të ligjshëm në një procedurë prokurimi, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, duhet të përmbajë dokumentin

bankar, që vërteton pagesën paraprake të tarifës përkatëse. 2.Përjashtimisht, kur legjislacioni në fuqi parashikon një mjet tjetër komunikimi, ankesa e paraqitur pranë KKP-së shoqërohet me dokumentin bankar, që vërteton pagesën paraprake të tarifës përkatëse në numër të llogarisë të KPP-së. 3.Për shqyrtimin e ankesës nga KPP-ja, përcaktohet kjo tarifë pagese, e cila është 0,5% e vlerës së fondit limit në procedurën e prokurimit, që ankimohet. 4.Parapagimi i tarifës nga ankuesi përbën element të domosdoshëm për paraqitjen e ankesës, ndërsa moskryerja e tij përbën shkak për mospranimin e ankesës nga KPP-ja” . Në Vendimin nr. 596/2018, datë 12.09.2018 të Komisionit të Prokurimit Publik “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik” parashikohet shprehimisht se: Ankesa drejtuar Komisionit paraqitet në gjuhën shqipe në përputhje me formularin standard të ankesës sipas modelit të aneksit nr. 2, që i bashkëlidhet kësaj rregulloreje. Komisioni publikon në faqen zyrtare formularin standard të ankesës.

2. Ankesa duhet të përmbajë domosdoshmërisht elementet e mëposhtme:

a) Të dhënat identifikuese të ankimuesit;

b) Referimin për procedurën konkrete mbi të cilën paraqitet ankimi

c) Bazën ligjore;

d) Një përshkrim të shkurtër të shkeljes së pretenduar;

e) Shkallët e ankimit shoqëruar me dokumentacionin përkatës dhe vendimin e autoritetit kontraktor, nëse ka;

f) Dokumentin bankar që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën;

g) Pretendimin e ankuesit për vendimin përfundimtar.

3. Ankesa, sipas rastit, mund të shoqërohet edhe me:

a) provat dokumentare, të cilat ankimuesi kërkon të shqyrtohen nga Komisioni;

b) kërkesën për përjashtimin e ndonjë anëtari të Komisionit për shkak të konfliktit të interesit, nëse ankimuesi ka dijeni paraprakisht për shkakun;

c) kërkesën për ekspertizë të posaçme, kur kjo çmohet e nevojshme për zgjidhjen e çështjes

III.1.2. Referuar procedurës së prokurimit objekt ankimi, KPP konstaton se kjo procedurë prokurimi është e ndarë në lotë dhe vetë operatori ekonomik ankimues parashtron pretendime në lidhje me përmbushjen e kriterëve të kualifikimit nga operatori ekonomik “Aurora Konstruksion” shpk referuar loteve ku ky i fundit ka marrë pjesë.

III.1.3. Neni 29 i Vendimit nr.914 datë 29.12.2014 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar parashikohet shprehimisht:

*Kur kontratat për punë/mall/shërbim ndahet në lote, autoriteti kontraktor duhet të hartojë kërkesat e veçanta të kualifikimit për secilin lot. Kërkesat duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin, natyrën dhe vlerën e lotit.*

*“Në çdo rast, lotet janë të organizuara si procedura të veçanta brenda një procedure. Fillimi dhe përfundimi i njërit lot nuk ndikon në lotin tjetër të procedurës*

III.1.4. KPP vëren se ankimuesi në parashtrimet në ankesë kundërshton kualifikimin e operatorit ekonomik “Aurora Konstruksion” shpk me argumentat se nuk plotëson kushtet kumulative për të gjitha lotet. Ndërkohë KPP vëren se ankesa e operatorit ekonomik ankimues i referohet vetëm lotit 1 me objekt “Rikonstruksion i disa QSH- ve në qarqet Tiranë, Durrës, Dibër”, dhe rrethimisht ankimuesi ka paguar tarifën e ankesës vetëm për lotin 1. Komisioni i Prokurimit Publik sqaron se neni 63 pika 1.1. e ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” të ndryshuar rregullon të drejtën e personave të interesuar në një procedurë prokurimi për të paraqitur ankesë në KPP, në kuadrin e rishikimit administrativ të kësaj procedure, e thënë ndryshe, legjitimitimin për të vënë në lëvizje KPP.

Procedura përpara KPP ka natyrën e procedurave të nxitura (*lat.-jurisdicion voluntari*) pasi KPP nuk mund të bëhet vetiniciatore e fillimit të procedurave (*ex officio*). Si rregull, investimi i KPP është i bazuar (faktikisht i kufizuar) nga ankimet e sjella pranë saj vetëm nga subjekte të legjitimuar. KPP sqaron Interesi në gjykim përcakton edhe pozitën procedurale të palëve në proces. Komisioni i Prokurimit Publik vlerëson se e drejta ligjore e subjektit për parashtrimin e një pretendimi para Komisionit të Prokurimit Publik për mborjtjen e një interesi të caktuar që njihet si legjitimimi, së bashku me ccështjen e kompetencës lëndore të ogranit administrativ njihet që specifikohen ndryshe edhe si “objekti i ankesës” ( pika 2 gërma “g” e Vendimit nr.596/2018, datë 12.09.2018 të Komisionit të Prokurimit Publik “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik ) si edhe kushti i shterimit të ankimit administrativ pranë autoritetit kontraktor ( neni 63 pika 2 e ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” të ndryshuar) janë kriteret përcaktuese për të filluar edhe një shqyrtim administrativ pranë Komisionit të Prokurimit Publik. KPP konstaton se operatori ekonomik ankimues ka parashtruar pretendime në lidhje me ligjshmërinë e veprimeve të autoritetit kontraktor për kualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Aurora Konstruksion” shpk duke e lidhur këtë të fundit me ligjshmërinë e veprimeve ( kualifikimin/skualifikimin) nga lote të tjera të procedurës së prokurimit, për të cilat, operatori ekonomik ankimues nuk ka shteruar rrugën e ankimit administrativ pranë autoritetit kontraktor si edhe Komisionit të Prokurimit Publik në respekt të nenit 63 pika 2,3,5,6,10 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” të ndryshuar. Kështu, KPP konstaton se operatori ekonomik me anë të ankesë së tij për lotin e procedurës së prokurimit objekt ankimi ka kërkuar kryerjen e rishikimit administrativ referuar loteve të tjera të procedurës së prokurimit për të cilat nuk janë përmbushur asnjë nga kushtet formale të paraqitjes së ankesës. Në nenin 29 të Vendimit nr.914 datë 29.12.2014 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar parashikohet shprehimisht se: “ “Në çdo rast, lotet janë të organizuara si procedura të veçanta brenda një procedure. Fillimi dhe përfundimi i njërit lot nuk ndikon në lotin tjetër të procedure” . Në rregullat e prokurimit public është përcaktuar qartësisht se fillimi dhe

përfundimi i njërit lot nuk ndikon në lotin tjetër duke e paraparë si procedurë të vecantë brenda një procedure. Në rastin konkret, që ankimesi të gëzoj lëgjitimet aktiv si edhe legjitimitet të vërë në lëvizje Komisionin e Prokurimit Publik (*lat- locus standi*) të shqyrtojë dhe vlerësojë dokumentacionin e paraqitur nga operatorë të tjerë ekonomikë në lote të tjera të procedurës së prokurimit do të duhej që ankimesi të kishte ezauruar ankim administrativ edhe për lotet në të cilat ngre pretendime. Në të kundërt, Komisioni i Prokurimit Publik nuk gëzon kompetenca lëndore të shqyrtimit të ligjshmërisë së veprimeve (kualifikimit/skualifikimit) të operatorëve të tjerë ekonomikë, megjithëse ankesa është e lidhur me lotin konkret, në lote për të cilat nuk është ushtruar e drejta e ankimit e për rrjedhojë KPP nuk ka ushtruar të drejtën e tij ligjore të shprehet si me vendime të ndërmjetme për pezullimin e procedurës dhe /ose kërkimin e informacionit si edhe me vendim përfundimtar mbi themelin e çështjes. Komisioni i Prokurimit Publik vlerëson të sqarojë se ky i fundit është paraparë nga ligjvënësi si një organ “sui generis”, për të cilin Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut ka përdorur termin e ri leksikor, quasi gjykatë, e pranuar edhe nga Gjykata Kushtetuese. Në rastin konkret, ankesa në KPP dhe rishikimi administrativ i procedurës së prokurimit kushtëzohet nga dy komponentë bazë, ai i ndjekjes së rrugës së ankimit administrativ pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe i kryerjes së veprimeve procedurale (pagimit të tarifës) si shkak për nisjen e shqyrtimit administrativ. Sa më sipër, KPP gjykon se kjo e fundit nuk mund të shqyrtojë dhe vlerësojë mbi dokumentacione të dorëzuara në lote të tjera të procedurës së prokurimit në kushtet për faj të ankimesit ky i fundit nuk ka ezauruar ankimin administrativ në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi për lotet e mësipërme.

Sa më sipër KPP gjykon se nuk mund të marrë në shqyrtim pretendimet e sipërcituara të ankimesit për pretendime që lidhen me përmbushjen e kushteve kumulative për të gjitha lotet por do të gjykojë të gjitha pretendimet e ngitura nga ankimesi që kanë lidhje me lotin objekt ankimi si më poshtë vijon.

III.2. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimes “Rafini Company” shpk & “Meteo” shpk mbi kualifikimin e operatorit ekonomik “Aurora Konstruksion” shpk me argumentet se *“Lidhur me pikën 2.3.7, 2.3.7 Operatori ekonomik pjesmarres duhet te deklarroje inxhinierin e ndertimit, inxhinierin h/teknik ose mekanik dhe elektrik qe do te jene ne kantier sipas grafikut te punimeve: Per qarkun Tirane: 2 inxh.ndertimi; 1 inxh h/teknik ose mekanik dhe 1 inxh.elektrik. Per qarkun Durres: 1 inxh.ndertimi; 1 inxh h/teknik ose mekanik dhe 1 inxh.elektrik. Per qarkun Diber: 1 inxh ndertimi, 1 inxh elektrik dhe 1 inxh.h/teknik/mekanik Per sejcilin prej ketyre inxhinierëve te kantierit sipas pikes 4.1 duhet te paraqiten kontratat e punes brenda afatit te vlefshmerise se ketij objekti, diplomat dhe cv. Mbështetur në kriteret e përcaktuara në DT përvojën që kemi në fushën e prokurimeve publike kemi bindjen se ofertuesi Aurora Konstruksion nuk plotëson kërkesën e përcaktuar në pikën 2.3.7 të DT pasi kontratat e dorëzuara për inxhinierin e ndërtimit, inxh h/teknik ose mekanik dhe elektrik që do të jenë në kantier për qarqet Durrës, Tiranë dhe Dibër pasi dyshojmë që nuk janë të rregullt nga ana formale (ku përfshihet nënshkrimi nga palët) nuk janë brenda afatit të vlefshëmrisë së objektit të prokurimit si dhe nuk janë të siguruar në listpagesat e shoqërisë për periudhën shtator 2019-shkurt 2020”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,*

III.2.1. Në shtojcën 12 “Kriteret e Vecanta të Kualifikimit” pika 2.3.7 “Kapaciteti teknik” të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

- 2.3.7 Operatori ekonomik pjesmarres duhet te deklaroje inxhinierin e ndertimit, inxhinierin h/teknik ose mekanik dhe elektrik qe do te jene ne kantier sipas grafikut te punimeve:
- Per qarkun Tirane: 2 inxh.ndertimi; 1 inxh h/teknik ose mekanik dhe 1 inxh.elektrik.
- Per qarkun Durres: 1 inxh.ndertimi; 1 inxh h/teknik ose mekanik dhe 1 inxh.elektrik.
- Per qarkun Diber: 1 inxh ndertimi, 1 inxh elektrik dhe 1 inxh.h/teknik/mekanik
- Per sejcilin prej ketyre inxhinierëve te kantierit sipas pikes 4.1 duhet te paraqiten kontratat e punes brenda afatit te vlefshmerise se ketij objekti, diplomat dhe cv.

III.2.2. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike konstatohet se operatori ekonomik “Aurora Konstruksion” shpk në përmbushje të kriterit sa më sipër ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

- Deklaratë për Inxhinierët në Kantier me përmbajtje si vijon:

<i>Në kantier</i>	<i>Inxh Ndërtimi</i>	<i>Inxh H/TeknikMekanik</i>	<i>Inxh Elektrik</i>
<i>Tiranë</i>	<i>A. M</i> <i>A.J</i>	<i>V.J</i>	<i>M.Z</i>
<i>Durrës</i>	<i>A. B</i> <i>A.Gj</i>	<i>A.M</i>	<i>G.A</i>
<i>Dibër</i>	<i>V.K</i>	<i>A.H</i>	<i>A.Sh</i>

*Deklarojmë se të gjithë inxhinierët e deklaruar nga ana e shoqërisë sonë do të jenë të angazhuar vetëm për realizimin e kësaj kontrate*

- *Kontratë Pune Nr.2789 rep nr.1251 kol e lidhur para noterit më datë 26.03.2020 ndërmjet Aurora Konstruksion shpk në cilësinë e punëdhënësit dhe G. A në cilësinë e Punëmarrësit në pozicionin e Inxhinier Elektrik . Kjo kontratë lidhet për një periudhë 2 vjecare duke filluar nga data e nënshkrimit të saj. Diplomë nr.3720 në degën Elektroteknike,CV.*

- *Kontratë Pune nr. 2785 ref nr.1247 kol datë e lidhur para noterit më datë 26.03.2020 ndërmjet Aurora Konstruksion shpk në cilësinë e punëdhënësit dhe M. P në cilësinë e punëmarrësit në pozicionin e Inxhiniere Elektrike. Kjo kontratë lidhet për një periudhë 2 vjecare duke filluar nga data e nënshkrimit të saj. Diplomë Bachelor në Inxhinieri Elektrike lëshuar nga UPT, Diplomë Master Profesional në Automatizim Industrie, CV.*
- *Kontratë Pune Nr.2793 rep Nr.1254 Kol e lidhur para noterit më datë 27.03.2020 ndërmjet Aurora Konstruksion shpk në cilësinë e punëdhënësit dhe A.Sh në cilësinë e Punëmarrësit në pozicionin e Inxhinier Elektrik. Kjo kontratë lidhet për një periudhë 2 vjecare duke filluar nga data e nënshkrimit të saj, Diplomë nr.1482 në degën Elektroteknike , CV.*
- *Kontratë Pune Nr.2787 rep Nr.1249 kol e lidhur para noterit datë 26.03.2020 ndërmjet Aurora Konstruksion shpk në cilësinë e punëdhënësit dhe V. K në cilësinë e punëmarrësit në pozicionin e Inxhinier Ndërtimi, Diplomë nr.1021-3 në degën Ndërtim me titull Inxhinier Për Ndërtime Civile Industriale, CV.*
- *Kontratë Pune nr.2786 nr.1248 e lidhur para noterit datë 26.03.2020 ndërmjet Aurora Konstruksion shpk në cilësinë e punëdhënësit dhe A. B në cilësinë e punëmarrësit në pozicionin e Inxhinier Ndërtimi, Diplomë, Licencë, CV.*
- *Kontratë Pune nr.2788 nr.1250 e lidhur para noterit datë 26.03.2020 ndërmjet Aurora Konstruksion shpk në cilësinë e punëdhënësit dhe A.M në cilësinë e punëmarrësit në pozicionin e Inxhinier Ndërtimi/Strukturiste, Diplomë nr.3541 Inxhinier Ndërtimi profili strukturiste,*
- *Kontratë Pune Individuale Nr.4250 rep nr.1569 kol datë 29.06.2017 lidhur ndërmjet Aurora Konstruksion shpk në cilësinë e punëdhënësit dhe A.Gj në cilësinë e punëmarrëses në pozicionin e Inxhinier Ndërtimi, CV, Diplomë e Nivelit të Parë në Inxhineiri Ndërtimi lëshuar nga UPT , Diplomë Master i Shkencave në Ndërtim profili Strukturist, Libreze Pune, Ceritifikatë Kordinatorore për sigurinë dhe shëndetin në punë,*
- *Kontratë Pune Individuale Nr.4251 rep nr.1570 kol datë 29.06.2017 lidhur ndërmjet Aurora Konstruksion shpk në cilësinë e punëdhënësit dhe A.J në cilësinë e punëmarrësit në pozicionin e Drejtues Teknik si Inxhinier Ndërtimi, Diplomë Nr.1017-B Inxhinier për Ndërtime Civile Industriale, Licencë në zbatim, CV, Libreze Pune, Ceritifikatë Kompetencat për Punimet në Lartësi , Ceritifikatë Trajnimi.*
- *Kontratë Pune Individuale Nr.2784 rep nr.1246 kol datë 26.03.2020 lidhur ndërmjet Aurora Konstruksion shpk në cilësinë e punëdhënësit dhe A.M në cilësinë e punëmarrësit në pozicionin e Inxhinier Mekanik, Diplomë Nr.2736 Inxhinier Mekanik Drejtimi Energjitikë, Licencë në projektim, CV.*



- *Kontratë Pune Individuale Nr.228 rep nr.218 kol datë 20.04.2015 lidhur ndërmjet Aurora Konstruksion shpk në cilësinë e punëdhënësit dhe A.H në cilësinë e punëmarrësit në pozicionin e Drejtues Teknik Inxhinier Mekanik, Diplomë Inxhinier Mekanik për Impiante, Librezë Pune, CV, Certifikatë Trajnimi Auditor për Sistemin e Menaxhimit të Energjisë sipas ISO 50001:2011.*
- *Kontratë Pune Individuale datë 06.01.2020 lidhur ndërmjet Aurora Konstruksion shpk në cilësinë e punëdhënësit dhe V.J në cilësinë e punëmarrësit në pozicionin e Inxhinier Mekanik, Diplomë Inxhinier Mekanik për Industri, Librezë Pune, CV.*

III.2.3. Në nenin 46, pika 1 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese.” b) *aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës; [...*

Ndërsa në nenin 53/3 të LPP-së përcakohet se: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit... .”

III.2.4. Në Vendimin nr. 914, datë 29.12.2014 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 26, pika 8, parashikohet si më poshtë:

*Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kërkon:*

*a) licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe/ose*

*b) dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose*

*c) dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratë”.*

III.2.5. Kriteret për kualifikim vendosen që ti shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në bazë të nenit 66 të VKM nr.914 datë 29.12.2014 i

ndryshuar, Komisioni verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara duke kualifikuar kvetëm ato oferta që përmbushin kriteret për kualifikim të përcaktuara në dokumentat e tenderit.

III.2.6. Referuar sa më sipër KPP gjykon se operatori ekonomik “Aurora Konstruksion” shpk për plotësimin e kriterit lidhur me stafin teknik të kërkuar nga autoriteti kontraktor për procedurën e prokurimit objekt ankimi ka dorëzuar deklaratë për inxhinierët që do të qëndrojnë në kantier në përputhje me kërkesat në kriter. Gjithashtu për të gjithë inxhinierat e deklaruar ka paraqitur kontrata pune të vlefshme shumica e të cilave të lidhura para noterit së bashku me të gjithë dokumentacionin shoqërues diploma në profilet e kërkuara si dhe cv-të përkatëse.

III.2.7. Lidhur me pretendimet e ankimuesit mbi kontratat e punës se *dysshojmë që nuk janë të rregullt nga ana formale (ku përfshihet nënshkrimi nga palët) nuk janë brenda afatit të vlefshëmrisë së objektit të prokurimit si dhe nuk janë të siguruar në listpagesat e shoqërisë për periudhën shtator 2019-shkurt 2020*, KPP pasi mori në shqyrtim të gjithë dokumentacionin e dorëzuar nga operatori ekonomik “Aurora Konstruksion” shpk gjykon se është tërësisht i vlefshëm pasi kontrata janë lidhur para noterit, të nëshkruara regullisht nga palët si dhe mbulojnë afatin e vlefshëmrisë së kontratës objekt prokurimi sikundër kërkuar në kriterin e vecantë të kualifikimit.

III.2.8. Ndërsa sa i takon argumentave të ankimuesit se inxhinierat nuk janë të siguruar në listpagesat e shoqërisë për periudhën Shtator 2019-Shkurt 2020 KPP e gjen të pabazuar dhe në tejkalim të kërkesave të shprehura në kriterin e vecantë të kualifikimit. Konkretisht në kriterin e kualifikimit lidhur me disponimin e stafit inxhinierik KPP vëren se autoriteti kontraktor ka bërë një ndarje midis stafit inxhinierik në cilësinë e drejtuesit teknik për të cilët është kërkuar të figurojnë në listpagesat e shoqërisë për periudhën Shtator 2019-Shkurt 2020 dhe stafit inxhinierik të deklaruar në kantier në qarqet përkatëse për të cilët ka kërkuar dokumentacion por jo të figurojnë në listpagesat e shoqërisë për periudhën e sipërcituar.

Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se Autoriteti kontraktor në vlerësimin e ofertave nuk mund të përdorë asnjë kriter tjetër i cili nuk është i përfshirë në dokumentat e tenderit kjo në kuptim të nenit 55 “*Kriteret e Përcaktimit të Ofertës Fituese*” pika 2 e LPP i cili parashikon shprehimisht se: *Autoriteti kontraktor vlerëson dhe krahason ofertat e vlefshme, për të përcaktuar ofertën fituese, në përputhje me procedurat dhe kriteret e përcaktuara në dokumentet e tenderit. Nuk duhet të përdoret asnjë kriter, që nuk është përfshirë në dokumentet e tenderit.*

Sa më sipër pretendimet e operatorit ekonomik ankimues nuk qëndrojnë.

III.3. Lidhur me pretenimet e bashkimit të operatorëve ekonomik ankimues “Rafini Company” shpk & “Meteo” shpk mbi kualifikimin e operatorit ekonomik “Aurora Konstruksion” shpk me argumentet se *Pika 2.3.8. 2.3.8. Të ketë në stafin e punonjesve të pasqyruar ne list pagesa punonjës të pajisur me deshmi kualifikimi te sigurimit teknik nga IQT ose ekuivalente me te, të vlefshme: 5 (pese) punonjës elektrikist; 5 (pese) punonjës hidraulik/mekanik; 4(kater) punonjës murator; 3 (tre) punonjës pllakashtrues; 3 (tre) punonjes bojaxhi; 2 (dy) saldatore. Per punonjesit e siperpermendur te paraqiten deshmite*

*perkatëse të kualifikimit të sigurimit teknik si dhe kontrata e punës (të vlefshme). Mbështetur në kriteret e përcaktuara në DT përvojën që kemi në fushën e prokurimeve publike kemi bindjen se ofruesi Aurora Konstruksion nuk plotëson kërkesën e përcaktuar në pikën 2.3.8 lidhur me disponimin nga ana e tij të 5 punonjësve hidraulik/mekanik dhe 5 punonjës elektrikist pasi punonjësit e sipërpërmendur nuk janë të siguruar me kodet përkatëse sipas VKM nr.514 datë 20.09.2017 Për listën kombëtare të profesioneve.*

III.3.1. Në shtojcën 12 “Kriteret e Vecanta të Kualifikimit” pika 2.3.5 dhe 2.3.8 “Kapaciteti teknik” të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

2.3.5. *Operatori Ekonomik duhet të ketë numrin e nevojshëm të punonjësve për zbatimin e kontratës. Numri i punonjësve për periudhën **Shtator 2019- Shkurt 2020** të jetë mesatarisht **95 punonjës në muaj** (përfshirë dhe stafin drejtues teknik dhe jo drejtues teknik-inxhinierë si dhe stafin me certifikate IQT ose e barazvlefshme ), të vërtetuar me;*

- a. Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj për periudhën **Shtator 2019- Shkurt 2020**.*
- b. List- pagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohej nga legjislacioni në fuqi për periudhën **Shtator 2019- Shkurt 2020**.*

2.3.8. *Të ketë në stafin e punonjësve të pasqyruar në list pagesa punonjës të pajisur me dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik nga IQT ose ekuivalente me të, të vlefshme:*

- 5 (pese) punonjës elektrikist; 5 (pese) punonjës hidraulik/mekanik; 4(kater) punonjës murator;*
- 3 (tre) punonjës pllakashtrues; 3 (tre) punonjës bojaxhi; 2 (dy) saldatore.*
- Për punonjësit e sipërpërmendur të paraqiten dëshmitë përkatëse të kualifikimit të sigurimit teknik si dhe kontrata e punës (të vlefshme).*

III.3.2. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton se operatori ekonomik “Aurora Konstruksion” shpk në përmbushje të kriterit sa më sipër ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

- Listpagesat e sigurimeve shoqërore e shëndetësore për periudhën Janar 2019- Shkurt 2020.*
- Kontratë Pune Individuale Nr.9724 rep Nr.4513 Kol datë13.08.2019 lidhur ndërmjet Shoqëria Aurora Konstruksion shpk në cilësinë e pundhënësit dhe F.B në cilësinë e punëmarrësit në pozicionin specialist-elektricit, Dëshmi Kualifikimi lëshuar nga Drejtoria Rajonale e Formimit Profesional Durrës, Librezë Pune , Dëshmi Kualifikimi e Sigurimit Teknik e vlefshme.*

- *Kontratë Pune Individuale Nr.9725 Rep Nr.4514 Kol datë 13.08.2019 lidhur ndërmjet Shoqëria Aurora Konstruksion shpk në cilësinë e pundhënësit dhe E. D në cilësinë e punëmarrësit në pozicionin specialist-elektricitist, Certifikatë e përgatitjes profesionale lëshuar nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Dëshmi Kualifikimi e Sigurimit Teknik e vlefshme.*
- *Kontratë Pune Individuale Nr.9727 Rep Nr.4516 Kol datë 13.08.2019 lidhur ndërmjet Shoqëria Aurora Konstruksion shpk në cilësinë e pundhënësit dhe L.T në cilësinë e punëmarrësit në pozicionin specialist-elektricitist, Dëshmi Kualifikimi lëshuar nga Drejtoria Rajonale e Formimit Profesional Durrës, Dëshmi Kualifikimi e Sigurimit Teknik e vlefshme, Certifikatë lëshuar nga Drejtoria Rajonale e Formimit Profesional Publik Nr.14 Tiranë, Librezë Pune,*
- *Kontratë Pune Individuale lidhur ndërmjet Shoqëria Aurora Konstruksion shpk në cilësinë e pundhënësit dhe G.M në cilësinë e punëmarrësit në pozicionin elektrikist, Dëshmi Kualifikimi e Sigurimit Teknik e vlefshme.*
- *Kontratë Pune Individuale Nr.9728 Rep, Nr.4517 Kol lidhur ndërmjet Shoqëria Aurora Konstruksion shpk në cilësinë e pundhënësit dhe O.S në cilësinë e punëmarrësit në pozicionin specialist elektrikist, Dëshmi Kualifikimi e Sigurimit Teknik e vlefshme, Dëshmi Kualifikimi AQS/T/S9682018.*
- *Kontratë Pune Individuale Nr.9726 rep Nr.45/5 Kol datë 13.08.2019 lidhur ndërmjet Shoqëria Aurora Konstruksion shpk dhe G.C në cilësinë e punëmarrësit në pozicionin specialist hidraulik, Dëftesë pjekurie, Dëshmi kualifikimi, librezë pune, Dëshmi Kualifikimi e Sigurimit Teknik e vlefshme,*
- *Kontratë Pune Individuale Nr.9720 rep Nr.4509 Kol datë 13.08.2019 lidhur ndërmjet Shoqëria Aurora Konstruksion shpk dhe S.U në cilësinë e punëmarrësit në pozicionin specialist hidraulik, Dëshmi kualifikimi, librezë pune, Dëshmi Kualifikimi e Sigurimit Teknik e vlefshme,*
- *Kontratë Pune Individuale Nr.9721 rep Nr.4510 Kol datë 13.08.2019 lidhur ndërmjet Shoqëria Aurora Konstruksion shpk dhe E.Xh në cilësinë e punëmarrësit në pozicionin specialist hidraulik, Dëftesë pjekurie, Certifikatë e Përgatitjes Profesionale, Librezë pune, Dëshmi Kualifikimi e Sigurimit Teknik e vlefshme,*
- *Kontratë Pune Individuale datë 01.06.2018 lidhur ndërmjet Shoqëria Aurora Konstruksion shpk në cilësinë e pundhënësit dhe I.Th në cilësinë e punëmarrësit në pozicionin Mekanik, Dëshmi Kualifikimi e Sigurimit Teknik e vlefshme, librezë pune, Certifikatë trajnimi AQSCERT, Dëshmi kualifikimi*
- *Kontratë Pune Individuale datë 01.06.2018 lidhur ndërmjet Shoqëria Aurora Konstruksion shpk në cilësinë e pundhënësit dhe O.J në cilësinë e punëmarrësit në pozicionin Mekanik, Dëshmi Kualifikimi, Dëshmi Kualifikimi e Sigurimit Teknik e vlefshme, librezë pune, Certifikatë trajnimi AQSCERT,*

III.3.3. Në nenin 46, pika 1 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese.” b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës; [...

Ndërsa në nenin 53/3 të LPP-së përcaktohet se: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit... .”

III.3.4. Në Vendimin nr. 914, datë 29.12.2014 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 26, pika 8, parashikohet si më poshtë:

*Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kërkon:*

a) *licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe/ose*

b) *dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose*

c) *dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratë”.*

III.3.5. Kriteret për kualifikim vendosen që ti shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

III.3.6. Në Vendimin nr. 514, datë 20.09.2017 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve (LKP), të rishikuar”, parashikohet:

1. *Miratimin e Listës Kombëtare të Profesioneve (LKP), të rishikuar, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.*

2. *Klasifikimi i Listës Kombëtare të Profesioneve, e njohur shkurtimisht si “LKP”, zbatohet për mbledhjen, klasifikimin dhe publikimin e të dhënave statistikore zyrtare.*

3. *Lista Kombëtare e Profesioneve (LKP) zbatohet nga agjencitë statistikore, ministritë e linjës, institucionet qendrore dhe vendore, personat fizikë dhe juridikë, brenda territorit të Republikës së*

*Shqipërisë.*

4. Kodet statistikore të Listës Kombëtare të Profesioneve (LKP), të përdorura deri para hyrjes në fuqi të këtij vendimi, zëvendësohen me kodet e parashikuara në Listën Kombëtare të Profesioneve (LKP), bashkëlidhur këtij vendimi.

5. Instituti i Statistikave dhe agjencitë e tjera statistikore kryejnë përditësimin e informacionit statistikor zyrtar, duke filluar nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

6. Ngarkohen institucionet dhe subjektet e përmendura në pikën 3, për marrjen e masave përgatitore për zbatimin e Listës Kombëtare të Profesioneve (LKP), brenda gjashtë muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

III.3.7. Referuar kriterit të vecantë të kualifikimit të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet se operatorët ekonomik duhet të kenë të punësuar në stafin e tyre të pasqyruar në list pagesa punonjës të pajisur me deshmë kualifikimi të sigurimit teknik nga IQT ose ekuivalente me të, të vlefshme: 5 (pese) punonjës elektrikist; 5 (pese) punonjës hidraulik/mekanik;.....Per punonjesit e siperpermendur te paraqiten deshmitë perkatese te kualifikimit te sigurimit teknik si dhe kontrata e punes (te vlefshme).

III.3.8. Referuar VKM nr.514 datë 20.09.2017 “Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve (LKP), të rishikuar, KPP vëren se kodi korenspondues i profesioneve të kërkuara në kriterin e vecantë të kualifikimit përkatësisht elektrikist, hidraulik, dhe mekanik është si vijon:

7411.01      Elektricist

7126.03      Hidraulik

7233.04      Mekanik për makineri Industriale

III.3.8. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik “Aurora Konstruksion” shpk në sistemin e prokurimeve elektronike në përmbushje të këtij kriteri rezulton se janë paraqitur kontratat e punës, dëshmi të kualifikimit të sigurimit teknik të vlefshme, për punonjësit me profesion elektrikist dhe hidraulik/mekanik sikundër kërkuar në kriterin e kualifikimit. Gjithashtu janë dorëzuar listpagesat e sigurimeve shoqërore e shëndetësore për periudhën e kërkuar nga ku KPP konstaton se për punonjësit e kontraktuar nuk rezultojnë mospërputhje me kodet e profesioneve të përcaktuara në VKM nr. 514, datë 20.09.2017 ”Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve”, në të cilën janë përcaktuar kodet përkatëse me profesionet sipas listës kombëtare. KPP vëren se punonjësit e deklaruar në kontratë për një pozicion të caktuar, edhe sipas listëpagesave të operatorit ekonomik “Aurora Konstruksion” shpk janë të deklaruar në atë profesion që janë kontraktuar, fakt ky që krijon sigurinë se operatori ekonomik përmbush kriterin e përcaktuar në dokumentat e procedurës së prokurimit objekt ankimi.

III.3.9. Bazuar në kodet e profesioneve të deklaruara në listëpagesat, konstatohet se operatori ekonomik “Aurora Konstruksion” shpk ka paraqitur dokumentacion të vlefshëm për të gjithë punonjësit e kontraktuar si më sipër analizuar pasi janë paraqitur kontratat e punës së bashku me dëshmitë e kualifikimit të sigurimit teknik të vlefshme lëshuar nga organet kompetente si dhe në listpagesat e shoqërisë këta punonjës janë deklaruar sipas përcaktimeve në VKM

nr.514 datë 20.09.2017 *Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve (LKP)*, të rishikuar, përkatësisht punonjësit e kontraktuar me profesion elektrikist janë deklaruar në listpagesa me kodin 7411.01, punonjësit e kontraktuar me profesion hidraulik janë deklaruar në listpagesa me kodin 7126.03 dhe punonjësit e kontraktuar me profesion mekanik janë deklaruar me kodin 7233.04.

III.3.10. Nisur nga sa më lart, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon dhe vlerëson se dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik “Aurora Konstruksion” shpk, “në këtë procedurë prokurimi arrin të provojë faktin që operatori ekonomik për gjithë periudhën e kërkuar në dokumentat e tenderit ka të punësuar në stafin e tyre punonjës me profesionet e kërkuara në dokumentat e procedurës së prokurimit objekt ankimi të deklaruar me profesionet përkatëse në listpagesat e shoqërive ndaj dhe dokumentacioni i paraqitur prej tij konsiderohet i vlefshëm.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

III.4. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Rafini Company” shpk & “Meteo” shpk mbi kualifikimin e operatorit ekonomik “Aurora Konstruksion” shpk me argumentet se *Pika 2.3.6. Operatorët ekonomike pjesëmarrës duhet të kenë drejtues teknik të punësuar per periudhen e kerkuar Shtator 2019- Shkurt 2020 të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, CV:*

- *Inxhinier Ndërtimi*
- *Inxhinier Mekanik ose H/teknik*
- *Inxhinier Elektrik*

*Mbështetur në kriteret e përcaktuara në DT, përvojën që kemi në fushën e prokurimeve publike kemi bindjen se ofertuesi Aurora Konstruksion nuk plotëson kërkesën e përcaktuar në pikën 2.3.6 pasi drejtuesit teknik të kërkuar nuk janë të siguruar me kohë të plotë për periudhën shtator 2019-shkurt 2020 sikurse parashikon VKM nr.41 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi i ndryshuar”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,*

III.4.1. Në shtojcën 12 “Kriteret e Vecanta të Kualifikimit” pika 2.3.5 “Kapaciteti teknik” të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

2.3.5. *Operatori Ekonomik duhet të ketë numrin e nevojshëm të punonjësve për zbatimin e kontratës. Numri i punonjësve për periudhën Shtator 2019- Shkurt 2020 të jetë mesatarisht 95 punonjës në muaj (përfshire dhe stafin drejtues teknik dhe jo drejtues teknik-inxhinierë si dhe stafin me certifikate IQT ose e barazvlefshme ), të vërtetuar me;*

- Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj per periudhen Shtator 2019- Shkurt 2020.*
- List- pagesat e punonjesve sipas formatit qe kerkohet nga legjislacioni ne fuqi per periudhen Shtator 2019- Shkurt 2020.*

2.3.6. *Operatorët ekonomike pjesëmarrës duhet te kenë drejtues teknik të punësuar per periudhen e kerkuar Shtator 2019- Shkurt 2020 të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, CV:*

- *Inxhinier Ndërtimi*
- *Inxhinier Mekanik ose H/teknik*
- *Inxhinier Elektrik*

III.4.2. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton se operatori ekonomik “Aurora Konstruksion” shpk në përmbushje të kriterit sa më sipër ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

- Kontratë Pune Individuale Nr.2289 Rep nr.968 Kol lidhur ndërmjet Aurora Konstruksion shpk në cilësinë e punëdhënësit dhe Xh. K (S) në cilësinë e punëmarrësit në pozicionin Drejtues Teknik Ing Elektrik, Licencë në zbatim, projektim, Diplomë, Librezë Pune, CV, Dëshmi Kualifikimi e Sigurimit Teknik,
- Kontratë Pune Individuale Nr.2287 Rep Nr.966 Kol lidhur ndërmjet Aurora Konstruksion shpk në cilësinë e punëdhënësit dhe A.M në cilësinë e punëmarrësit në pozicionin Drejtues Teknik, Ing Hidroteknik, Licencë në zbatim, Diplomë, Librezë Pune, CV.
- Kontratë Pune Individuale Nr.2283 Rep Nr.962 Kol lidhur ndërmjet Aurora Konstruksion shpk në cilësinë e punëdhënësit dhe I.Gj në cilësinë e punëmarrësit në pozicionin Drejtues Teknik, Ing Ndërtimi, Licencë në zbatim, në projektim, Diplomë, Librezë Pune, CV, Certifikatë për vlerësim të ndikimit në mjedis.

III.4.3. Në nenin 46, pika 1, gërma “b” të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht: *“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese.” Aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës”*

III.4.4. Në nenin 53, pika 3 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet: *“Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...”*

III.4.5. Në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 26, pika 8, parashikohet si më poshtë:



*Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kërkon:*

*a) licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe/ose*

*b) dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose*

*c) dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratë”*

Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit.

Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme.

III.4.6. Nga shqyrtimi në tërësi i dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik “Aurora Konstruksion” shpk rezulton se ky i funksionit disponon në stafin e tij Drejtuesit Teknikë sipas profileve të kërkuara në kriterin e vecantë të kualifikimit përkatësisht Elektrik, Hidroteknik dhe Ndërtimi. Drejtuesit teknike janë të pajisur me dokumentacionin e kërkuar në kriterin e kualifikimit, kontratë pune , diplomë, cv, licencë. Gjithashtu drejtuesit teknike të kontraktuar janë të pasqyruar në listpagesat e shoqërisë për periudhën e kërkuar Shtator 2019- Shkurt 2020. Akoma më tej nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar nga operatori Aurora Konstruksion shpk lidhur me drejtuesit teknike, KPP vëren se edhe pse në kriter nuk është bërë asnjë përcaktim lidhur me punësimin me kohë të plotë të drejtuesve teknike, drejtuesit teknike të kontraktuar nga shoqëria Aurora Konstruksion shpk janë të punësuar me kohë të plotë.

Sa më sipër pretendimi i BOE ankimues nuk qëndron

III.5. Lidhur me pretendimet e BOE ankimues mbi operatorët ekonomikë “Dajti Park” shpk dhe “Kevin Konstruksion” shpk, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, fati i shoqërive është përcaktuar tashmë prej vendimit të KVO-së të datës 25.06.2020 ku këto shoqëri rezultojnë të skualifikuara nga kjo procedurë prokurimi, e për rrjedhojë pa asnjë ndikim në interesat e ankimuesit. Për më tepër, nga verifikimi i informacionit të paraqitur nga autoriteti

kontraktor, si dhe nga shqyrtimi administrativ në KPP, nuk rezulton që operatorët ekonomikë të jenë ankimuar në lidhje me këtë procedurë prokurimi.

Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksonimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri

### **Vendos**

1. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga BOE “Rafin Company” shpk& “Meteo” shpk për procedurën e prokurimit, “*Procedurë e Hapur*”, me nr. REF-51811-02-27-2020 me objekt Loti 1 “*Rikonstruksion i disa QSH- ve në qarqet Tiranë, Durrës, Dibër*” me fond limit 131,310,315 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 30.03.2020 nga autoriteti kontraktor, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
3. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Nr. 744 Protokolli; Datë 13.07.2020**

### **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Anëtar**  
**Vilma Zhupaj**

**Anëtar**  
**Lindita Skeja**

**Anëtar**  
**Merita Zeqaj**

**Kryetar**  
**Jonaid Myzyri**

